

STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së, 15 maj 2015, Nr.3, Viti IV

Seida Suma, u zgjodh kryetare e Unionit Studentor të AAB-së

faqe 6

Studentët e AAB: Rruga e Kosovës për në BE - si një labirinth



faqe 11

Marc Gruber: "Gazetaria hulumtuese duhet t' i shërbejë publikut"



faqe 17

Prof. Agim Vinca: Vepra "Shtini n'dhe këto fjalë" lexohet lehtë, por nuk shlyhet nga kujtesa



faqe 18



Konferenca e Tretë Shkencore Ndërkombëtare për Arkitekturë IAC/KNA-2015

faqe 2



20 studentë të përzgjedhur, pjesë e sistemit tutorial të AAB-së gjatë semestrit veror 2014/15

faqe 6



AAB thellon bashkëpunimin me universitete të njohura nga Turqia

faqe 5

Konferenca e Tretë Shkencore Ndërkombëtare për Arkitekturë IAC/KNA-2015

“ARKITEKTURA DHE IDENTITETI- Çështjet kritike në diskursin bashkëkohor në qasje rajonale”, kështu është titulluar Konferenca e Tretë Shkencore Ndërkombëtare për Arkitekturë dhe Planifikim Urban, organizuar nga Universiteti AAB, e cila i mbajti punimet në Universitetin AAB.

Tashmë tradicionale, kjo Konferencë ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm te akademikët, studiuesit dhe profesionistët e kësaj fushe jo vetëm nga vendi dhe rajoni, por edhe nga shtetet tjera si: Kroacia, Sllovenia, Austria, Italia, Greqia, Turqia, etj., ndërsa pjesëmarrës në Konferencë përmes prezantimeve virtuale janë edhe studiues dhe arkitektë të njohur nga Gjermania, Franca dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Temat që do të shtjellohen në konferencë janë nga fusha e arkitekturës, urbanizmit, identitetit, trashëgimisë, racionalizmit, arkeologjisë dhe globalizmit.

Me rastin e hapjes së punimeve të konferencës, Rectori i Universitetit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa, tha se çështjet e arkitekturës dhe të urbanizmit gjithëherë e më shumë po bëhen çështje jetike për ekzistencën tonë dhe funksionalitetin e qytet-

eve dhe vendbanimeve, për shkak të zhvillimit të hovshëm të tyre, andaj konsideroj, pikërisht është detyrë e universiteteve, sidomos e fakulteteve të arkitekturës, profesorëve dhe studentëve që me profesionalizimin e tyre, vullnetin përkushtimin dhe kreativitetin krijues të kontribuojnë në zhvillimin e qyteteve dhe vendbanimeve tona.

Në hapjen e punimeve të konferencës mori pjesë edhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë e Kosovës, prof. dr. Ferid Agani, i cili tha se siguri i mirëqenies së qëndrueshme për qytetarët e vendit dhe krijimi i hapësirave me standarde për një jetesë të shëndoshë, është obligim i çdo profesionisti të angazhuar në këtë proces. Ministri Agani gjithashtu ka shprehur gatishmërinë e ministrisë që ai e drejton për të gjetur zgjidhje për problematikat që paraqiten rreth fushës së arkitekturës dhe planifikimit urban dhe se së shpejti do të fillohet që këto çështje të vihen në binarë me Ligjin për Odat e Arkitektëve dhe Ndërtimtarëve.

Punimet e konferencës do të zhvillohen në disa sesione. Te sesioni “Arkitektura dhe Identiteti” ligjëratën kryesore e mbajti Giorgio



Gianighian, në temën “Autenticiteti dhe Identiteti në Konzervimin arkitektural dhe urban: disa Reflektime” dhe Andrea Griletto “Autenticiteti dhe Koherenca: Restaurimi i Mesxhidit të Sheik Sulejmanit në Stamboll”. Në sesionet tjera u prezantuan këto tema: Vjollca Aliu, Enver Rexha, Milot Berisha, Arben Hajdari, Florina Jerliu “Projekti i lokalitetit arkeologjik Ulpiana’ 2014-15”. Nora Demjaha & prof. Pavlos Lefas “Forma e shtëpisë dhe identiteti. Rasti i Athinës moderne”, Peter Gobrijelcic “Contemporary slovenian architecture” Art-

Januzi-Cana “Druri si pjesë e identitetit arkitektonik –një vështrim i zhvillimit të arkitekturës së drurit në Kosovë”, Borut Juvanec “Arkitektura vernakulare sllovene, problematikat dhe zgjidhjet e mundshme” Adeline Tahiri “[Ri]Ndërtimi i Identitetit nëpërmjet qytetit bashkëkohor” Eliza Hoxha “Prishtina ID-entiteti”, Arbnor Murati “Prishtina Quo vadis?”. Gjatë kësaj konferencë u paraqitën edhe disa posterprezantime nga Identiteti sipas Dizajnit.

Në konferencën, me punimet e tyre hulumtuese

përveç që janë paraqitur studiuesit nga fushat e cekura dhe nga vendet e ndryshme të botës të cekura si më lartë, po ashtu u prezantuan edhe një varg punimesh e hulumtimesh të studiuesve të rinj, mësimdhënës universitarë dhe të institucioneve partnere të AAB-së dhe studentë të këtyre profileve. Konferenca i zhvillojë punimet dy ditë me radhë, me ç’ rast pjesëmarrësit bënë edhe një vizitë trashëgimisë arkitekturale e kulturore të Kosovës.



Impresum

STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së

Botues: BPrAL AAB

Kryeredaktor: Zija Rexhepi

Redaktore përgjegjëse: Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e AAB-së

Foto:

Rrahman Drenica dhe Ylli Selmani

Dizajni grafik:

Besfort Mehmeti

e-mail: info@aab-edu.net

Stafi akademik i AAB-së, u trajnuan për ngritjen e aftësive pedagogjike në dy punëtori të veçanta

Në kuadër të programit për ndërtimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore, Universiteti AAB, ka nisur implementimin e projektit për aftësimin pedagogjik të mësimitdhënësve të vet.

100 mësimitdhënës të të gjitha njësive akademike të AAB-së, pjesëmarrës vullnetarë, kanë marrë pjesë në dy punëtori në kuadër të këtij trajnimi, të cilat u mbajtën, përkatësisht më 30 janar 2015, dhe më 24 shkurt 2015, në Prevalë e Prishtinë.

“Qëllimi i këtij trajnimi që certifikohet nga ana e Institutit AAB, është avancimi i cilësisë së mësimitdhënies dhe i mjedisit për studime në AAB, përmes ngritjes së dijes e të shkathtësive pedagogjike të mësimitdhënësve”, ka thënë koordinatori i këtij programi, prof. Xhavit Rexhaj.

Në ditën e parë të trajnimit u zhvilluan mbi 15 seanca paralele ku u trajnuan këto tema:

Rezultatet e të nxëniet dhe metodologjia e punës; Komunikimi psikologjik në procesin mësimit; didaktika e arsimit të lartë; Stilet e të nxëniet dhe inteligjencat e shumëfishta dhe Të nxëniet konstruktivitet, kurse në ditën e dytë të trajnimit u zhvilluan 16 seanca paralele në temat në vijim: Pyetje efektive për të kuptuarit e thellë; Të nxëniet e bazuar në përvojë; Vlerësimi i studentëve; dhe Frustrimet në procesin mësimit dhe reagimet e mundshme. Në të dyja trajnimet ligjëruan njohës të dëshmuar dhe trajnerë të certifikuar në profesionet caktuara si, prof. dr. Neki Juniku, prof. dr. Naser Zabeli, prof. dr. Demë Hoti, prof. dr. Shemsedin Vehapi, prof. Alban Asllani dhe Xhavit Rexhaj.

Po ashtu, gjatë punëtorisë së dytë vijuesit u aftësuan edhe për përdorimin e sistemit të digjitalizuar të të mësuarit dhe komunikimit me studentë

(e-Professor) në kuadër të platformës së integruar të të nxëniet elektronik e-AAB, nga Valdete Daku, zhvilluese softuerike në AAB dhe Xhavit Rexhaj, Ph.Dc. Objektivi i të gjitha sesioneve ka qenë ndërtimi i të kuptuarit të përbashkët për qasjet dhe metodologjitë e reja në mësimitdhënie e të nxëniet për të rriturit, diskutimi dhe përvetësimi i metodave e teknikave për transformimin e qasjeve në praktika të mësimitdhënies e të nxëniet dhe diskutimi i përvojave të mira të kolegëve për krijimin e një ambienti miqësor të të nxëniet.

Në mbyllje të punëtorisë rektori prof. dr. Lulëzim Tafa, falënderoi pjesëmarrësit për punën aktive dhe premtoi përkrahje të vazhdueshme për zhvillimin profesional dhe avancimin e pandërprerë për stafin akademik të këtij institucioni.



Studentët e Fakultetit Juridik për praktikë profesionale në FDH – Kosovë

Fakulteti Juridik i Universitetit AAB në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë), gjatë këtyre ditëve kanë përzgjedhë një grup të studentëve të po këtij Fakulteti për ta mbaruar praktikën profesionale 3-6 muaj.

Gjatë këtyre ditëve në Pallatin e Drejtësisë, studentët janë vizituar nga stafi akademik i AAB-së, Artan Fejzullahu dhe Enisa Haliti, me qëllim që të informohen nga afër me aktivitetet dhe arritshmërinë e studentëve gjatë realizimit të projektit.

“Kjo praktikë do të jetë një mundësi e mirë për studentët e Universitetit AAB, që të shohin nga afër punën e gjyqësorit në Kosovë, dhe do të kenë njohuri më të mëdha në profesionin e tyre”, tha Enisa Haliti.



U publikua numri më i ri i revistës kërkimore-shkencore “ABSTRAKT”



U publikua numri i parë i revistës kërkimore-shkencore “ABSTRAKT” të Universitetit AAB- dega në Ferizaj. Numrin e ri të kësaj revistës mund ta shfletoni në uebfaqen: http://aab-edu.net/uploads/docs/abstract/abstrakt_1.pdf.

Arkitekti i njohur Andrea Griletto ligjëroi para studentëve të AAB-së



Profesori Andrea Griletto në fillim të ligjëratës foli për marrëveshjen e bashkëpunimit mes Italisë dhe Turqisë për restaurimin e trashëgimisë kulturore, i cili bashkëpunim filloi në vitin 2005, nëpërmjet organeve institucionale dhe kompanive.

“Ky bashkëpunim është forcuar kur kemi filluar për të punuar së bashku për një projekt të restaurimit të përbashkët mes Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë (TBMM) dhe ICE/ për Restaurimin e Kullës së Pallatit Dolmabahe në vitin 2008”, kështu ka thënë para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës të AAB-së, arch. phd. Andrea Griletto.

“Deri më tani, ky bashkëpunim paraqet praktikën më të mira të arritura ndonjëherë nga qeveria italiane në fushën e restaurimit, në kuadër të politikës së promovimit jashtë vendit të ekspertizave italiane dhe ndërmarrjeve private”, ka thënë prof. Griletto.

Po ashtu në bazë të këtij bashkëpunimi ART Project, ka të bëjë me promovimin e kompanive italiane të sektorit të restaurimit në Turqi. Ajo krijoi mundësi të vërtetë për të filluar me restaurimin e Sheikut Suleiman Mesjid (Xhami), në pronësi dhe i menaxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Fondacioneve (VGM). Të dyja kompanitë përfaqësojnë një nivel të lartë të bashkëpunimit të projektit dhe grupeve të punës nga të dyja vendet. Të dyja përfaqësojnë një kompromis të mirë midis zbatimit të pastër të modelit italian dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Turqi dhe praktikave lokale.

“Së pari janë marrë me restaurimin e sipërfaqeve të gurit të Kullës, me një qasje të rreptë konservatore, pa zëvendësim, në kundërshtim me modelet e mëparshme të restaurimit në bazë të prerjes dhe zëvendësimit të pjesëve të mëdha të gdhendura e dekorative. E dyta, që është më komplekse, zhvillon një pasuri multidisiplinare bashkëpunimi, duke përfshirë të gjitha aspektet e procesit të restaurimit të një ndërtese ende në përdorim, përtej teknikave të pastra të restaurimit”, citoi prof. Griletto.

Gjithashtu prof. Griletto, foli edhe për metodologjitë e projektit për restaurim, të cilat janë arritur nga profesionistët italianë dhe turq, nëpërmjet procesit të njohurive dhe të kuptuarit të ndërtesës dhe historisë së saj. Këto procese janë ndihmuar fuqimisht nga përdorimi i teknologjive të reja të tilla si nga skaneri-laser, analiza kimike, dhe jodestruktive për diagnostikim në terren. Arkeologët dhe historianët arkitektonikë, inxhinierë mekanikë dhe të elektrikës, piktorë etj,

ishin pjesë e grupit të punës, sipas qasjes multidisiplinare të kërkuar.

Gjatë kësaj ligjërate, prof. Griletto, mori edhe një krahasim në mes të qasjeve të ndryshme midis Italisë dhe Turqisë, por të dyja projektet e restaurimit mund të konsiderohen si një hap i vërtetë në funksion të krijimit të një bashkëpunimi afatgjatë.

Kurse sa i përket projektit Sheikut Suleiman Mesjid (Xhami), në veçanti, ka për qëllim të ruajë të gjitha materialet dhe sipërfaqet historike, pa fshirë një histori të ndërlikuar prej gati 1500 vjet, dhe, në të njëjtën kohë, duke përfshirë teknologjitë më të mira bashkëkohore për ngrohje, ftohje, forcim dhe ndriçim.

Profesori gjatë gjithë ligjëratës ka dhënë shembuj me foto, ku shiheshin punëtoret e të dyja shteteve duke punuar në grupe dhe në objektet e cekura, analiza kimike dhe krahasime të shumta, e deri te realizmi i punëve finale.



Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Ferizajt dhe AAB-së



Universiteti AAB, dega në Ferizajka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në fushën e politikave sociale me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Ferizajt.

Sipas kësaj marrëveshjeje, AAB do t'i ofrojë komunës bashkëpunim dhe mbështetje akademike në hartimin e projekteve sociale, projekteve hulumtuese, etj., ndërsa në anën tjetër komuna me kapacitetet e saja do të angazhojë një numër të studentëve për punë praktike në sektorin e mirëqenies sociale.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Burim Karameta, ka thënë se kjo marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion arsimor po vije në kohën kur komuna është shumë e angazhuar në projektet e mirëqenies sociale. Karameta, ka shtuar se kjo ndihmesë në planin akademik dhe teknik është më se e nevojshme ngase plotëson nevojat tona. “Marrëveshja specifikon fushat e bashkëpunimit në rrafshin social. Ne do ta shfrytëzojmë potencialin akademik të këtij institucioni për projektet tona”.

Ndërsa ndihmesa e jonë fokusohet në ofrimin e kapaciteteve tona për punë praktike të studentëve të shkencave sociale me qëllim të ngritjes profesionale të tyre”, ka thënë Karameta. Në anën tjetër, zyrtarët e Universiteti AAB kanë thënë se kjo marrëveshje hyn në kuadër të një bashkëpunimi që ky institucion i dijes i ka edhe me drejtoritë tjera. Drejtori i degës së Universiteti AAB në Fer-

izaj, MedainHashani, ka vënë në dukje se në kuadër të këtij institucioni funksionon drejtimi Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve, dhe me këtë është menduar që këta studentë krahas praktikës nëpër institucionet shkollore, në të njëjtën kohë edhe në programin për punë sociale të japin kontributin e tyre nga niveli akademik që mësojnë, në nivelin praktik.

“Ne si institucion jemi duke i mbështetur dhe do t'i mbështesim të gjitha rastet sociale që studiojnë në Universitetin AAB. Ata i kanë përqindjet e caktuara për studime në këtë universitet, po ashtu me kuadro do t'i mbështesim edhe në realizimin e të gjitha objektivave që dalin nga kjo drejtori. Ne kemi potencial të bollshëm akademik dhe teknik për t'i mbështetur të gjitha projektet e tyre”, ka nënvizuar MedainHashani.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional do të jetë pa kompensim material, gjë që e bënë edhe më serioze këtë marrëveshje kanë thënë akterët e saj.

“Kjo e tregon tërë seriozitetin e marrëveshjes që do të thotë se nuk bëhet fjalë për anën materiale por për aspektet humane”, ka shtuar Hashani. Ndërsa drejtori i DShMS, Burim Karameta, ka spikatur se ky bashkëpunim në fushën e projekteve do ta bëjë edhe më të lehtë përfitimin e donacioneve nga organizatat e ndryshme.

Ndryshe, u bë e ditur se edhe më parë Qendra për Punë Sociale e Ferizajt ka pasur një bashkëpunim me Universitetin AAB në fushën e hulumtimeve sociale.

AAB thellon bashkëpunimin me universitete të njohura nga Turqia

Nje ekip i AAB-së, i përbërë nga prof. Ilir Tafa, kryetar i bordit, Xhavit Rexhaj, prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar, Rizvan Rexhaj, udhëheqës i departamentit të marketingut, Granit Curri, sekretar i përgjithshëm dhe Engin Melekogllu, koordinator i programit në turqisht në AAB, qëndruan në një vizitë zyrtare dhe studimore në Ankara të Turqisë prej datës 10 deri 13 shkurt 2015.

Gjatë kësaj vizite delegacioni vizitoi Ambasadën e Kosovës në Turqi, Universitetin jopublik Çankaja, Universitetin TOBB, Këshillin e Arsimit të Lartë të Turqisë, Universitetin Atilim, Kompaninë Infocad dhe Universitetin e Shoqatës Turke të Aeronautikës. Vizita është organizuar dhe realizuar me ndihmën e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Turqisë.

Në ditën e parë të vizitës, delegacioni ka realizuar një takim me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Turqi, Shkëlqesinë e Tij, Avni Spahiu, dhe me z. Gynar Ureya, ministër-këshilltar në ambasadë. Delegacioni ishte i impresionuar me nivelin e lartë të organizimit, raportet e krijuara me institucionet e me popullin turk, dhe me mikpritjen e përkrahjen e rezervuar gjatë tërë vizitës. Gjatë bisedës delegacioni u informua për përgatitjet për shënimin e Ditës

Këshilli i Arsimit të Lartë i Republikës së Turqisë: Këshilli i Arsimit të Lartë mbulon funksione të shumta në sistemin e arsimit në Turqi. Ndër to përfshihet edhe funksioni i akreditimit dhe njohjes së institucioneve arsimore vendore dhe të huaja. Delegacionin e AAB-së e priti drejtori i departamentit për bashkëpunim ndërkombëtar, prof. dr. Sedat Gymysh dhe Myseme Mert nga njësia për Evropë e këtij departamenti. Në takim u bisedua për njohjen e diplomave të institucioneve ndërkombëtare, për mësimet në distancë dhe mundësitë e bashkëpunimit me institucionet turke të arsimit të lartë. Në takim u theksua se për çdo bashkëpunim institucional ndërkombëtar kërkohet domosdoshmëri miratimi i Këshillit të Lartë. Mikpritësit e informuan delegacionin e AAB-së se diplomat e AAB-së në përgjithësi njihen nga ky Këshill, me përjashtim të rasteve ku duhen respektuar specifikat turke (për shembull ligjet e shtetit të Turqisë në programet e drejtësisë) dhe profesioneve të rregulluara, ku kërkohet edhe provim shtetëror (njësoj sikurse për institucionet vendore). Palët u dakorduan për nevojën e informimit të vazhdueshëm për procedurat dhe rregulloret përkatëse që përcaktojnë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe



master dhe doktoratë. Universiteti hyn ndër 10 përqind të universiteteve më të mira botërore sipas të gjitha listave të rangimit të institucioneve të arsimit të lartë në botë dhe zhvillon bashkëpunim në kuadër të 36 marrëveshjeve për bashkëpunim në kuadër të programit evropian Erasmus. Universiteti dallohet edhe për organizimin e një shkolle shumë cilësore verore, që zgjat shtatë javë dhe ka një pjesëmarrje të lartë të studentëve nga mbarë bota. Të dyja delegacionet u morën vesh që të bashkëpunojnë në shkëmbimin e personelit, në konkurrim për projekte e fonde evropiane, në organizimin e studimeve në distancë, dhe në organizimin e përbashkët të shkollave verore. Po ashtu delegacionet u pajtuan që të aranzhohet një marrëveshje bilaterale për mobilitet të studentëve dhe të mendohet mësimdhënia e përbashkët e profesorëve në shkollën verore. Si fusha prioritare të bashkëpunimit u caktuan administrata publike, gjuha angleze, arkitektura dhe ekonomia. Në javët në vijim AAB do të dërgojë versionin e parë të marrëveshjes për bashkëpunim në mes të dy institucioneve.

Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë - TOBB: Ky universitet është i themeluar nga fondacioni i krijuar nga Oda Ekonomike e Turqisë. Është ndër institucionet më cilësore të arsimit të lartë në Turqi ku mësimi mbahet në gjuhën turke dhe angleze. Ndër kushtet për pranim është edhe njohja e mirë e gjuhës angleze për të gjithë studentët për të përdorur literaturën në këtë gjuhë. Universiteti dallohet për cilësinë dhe kohëzgjatjen e punës praktike që kryhet në

formë të mësimi dual në mëse një milion bizneset anëtare të Odës Ekonomike. Koordinatorja e Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar në këtë Universitet Birgul Demirtas, dhe dekan i Fakultetit më të madh të Ekonomisë dhe i Shkencave administrative, Ihsan Sezal ofruan bashkëpunim të plotë me Universitetin AAB. Palët u dakorduan që të fillojë bashkëpunimi në fushën e ndërkombëtarizimit të studimeve, shkëmbimit të studentëve, hartimin e projekteve të përbashkëta për Erasmus, projekte dhe publikime të përbashkëta shkencore, organizimin e përbashkët të shkollave verore, përdorimin e ndërsjellë të literaturës, forcimin e qendrës për mësim tërë jetësor, programe të shkurtra për certifikatë, etj.. Këto tema dhe aktivitete të bashkëpunimit do të përfshihen në marrëveshjen e bashkëpunimit që do të nënshkruhet gjatë vizitës së delegacionit të TOBB në AAB, në muajin prill 2015.

Universiteti Atilim: Ky është ndër 10 universitet më të avancuara turke për kërkime shkencore. Dy të tretat e programeve zhvillohen në gjuhën angleze me programe intensive të bashkëpunimit ndërkombëtar që realizohet nëpërmjet të mëse 70 marrëveshjeve përkatëse vetëm në Erasmus. Delegacionin nga AAB e pritën zëvendës rektori, prof. Ismail Birçan dhe prorektori për mësim, prof. Hasan Akaj. Palët u dakorduan që të punojnë së bashku në hartimin e një marrëveshjeje kornizë me fokus në fushat e mobilitetit të personelit e të studentëve, në projekte të përbashkëta akademike e shkencore, dhe në ngritjen e kapaciteteve shkencore të personelit të AAB-së. U ven-

dos po ashtu që bashkëpunimi të përqendrohet në fushën e ekonomisë, arkitekturës dhe artëve. Nënshkrimi i Marrëveshjes, pas miratimit të saj nga ana e Këshillit të Arsimit të Lartë, do të realizohet gjatë vizitës kthyesë në Kosovë, në prill 2015.

Universiteti i Asosciacionit Turk të Aeronautikës (UATA):

Në fund të vizitës, delegacioni u takua me ndihmës koordinatorin e Zyrës Ndërkombëtare të UATA, Dr. Emin Serin. Palët në takim u dakorduan që të punojnë në fushat si biznesi, ekonomia, dhe aeronautika me përqendrim në ofrimin e kurseve dhe programeve për certifikatë. Po ashtu kishte dakordim për shfrytëzimin e mundësive për shkëmbim të personelit dhe për hartim e konkurrim me projekte të përbashkëta për fonde evropiane.

Delegacioni pati edhe takime të tjera me biznese turke. Ndër to ishte edhe organizata Noktanet (Zt. Ynal Erdalogllu) në fushën e aplikacioneve softuerike dhe të transferit të teknologjisë e dijes. Palët diskutuan mundësitë e bashkëpunimit për themelimin e Qendrës për Inovacione në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike të AAB-së. Pos kësaj, delegacioni u takua edhe me themeluesin e Kompanisë Infocad, që përqendrohet në shërbimet përcjellëse për përkrahjen e studentëve turq në vend dhe jashtë. Palët u dakorduan që të punojnë së bashku për të lehtësuar procesin e regjistrimit të të interesuarve nga Turqia për studime në AAB. Vizita kthyesë në Kosovë do të jetë rast për finalizimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi në mes të dy organizatave.



së Pavarësisë së Republikës së Kosovës në Turqi, organizimin e takimeve në nivelet më të larta ndërmjet zyrtarëve të të dyja vendeve dhe nismën më të re të ambasadës sonë, hapjen së shpejti të Qendrës Kulturore Shqiptare në Ankara. Pos përkrahjes në organizimin e vizitës, ministri-këshilltar Urea ofroi përkrahje edhe gjatë realizimit të vizitave nëpër institucionet arsimore në Turqi.

studimet në distancë në të dyja vendet.

Vizita në Universitetin Çankaja: Në ditën e parë të vizitës, delegacioni u prit nga prorektori Kenan Tash dhe Aykut Kansu, dekan i Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin Çankaja. Universiteti Çankaja është ndër universitetet më elite në Turqi me rreth 8000 studentë që mësojnë në gjuhën angleze në studime të nivelin baçellor,

Ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Angelika Viets: Nuk e këshilluam Isa Mustafën me kënd të bëjë koalicion

Në një ligjëratë për studentët e AAB-së, në temën “Politika e jashtme gjermane”, Ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Angelika Viets, tha se meqë para formimit të qeverisë së Kosovës, ka ratisur që lideri i LDK-së, Isa Mustafa të vizitojë Berlinin, është krijuar përshtypja se qeveria gjermane e ka këshilluar atë t’i ndërrojë partnerët e koalicionit. Kjo nuk është aspak e vërtetë tha Ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Angelika Viets.

“Natyrisht ne i kemi vënë disa vija të kuqe Presidentes së Kosovës por nuk kemi ndërhyrë se kush me kë duhet të bëjë koalicion. Kjo ka qenë zgjedhje e vet liderëve politikë”.

Ajo po ashtu tha se emigrantëve kosovarë që kanë kërkuar azil në Gjermani, do t’u refuzohet qëndrimi dhe do të kthehen.

“Numri i kosovarëve që marrin rrugën për në perëndim si azilkërkues është rritur në mënyrë dramatike. Nuk do të pranohen! Çështjet ekonomike nuk janë arsye për azil. Norma e mospranimi është 100%. E vetmja mënyrë është vetëm nëse keni leje pune”, theksoi ambasadorja gjermane.

“Shumica për fat të keq u besojnë kriminelëve që u kanë premtuar ‘tokën e premtuar’. Ata do të kthehen më të varfër. Fluturimi i tyre paguhet nga qeveria”, tha ajo, duke shtuar se ky proces do të zgjasë 2 deri në 3 muaj.

Në këtë ligjëratë, ambasadorja gjermane foli edhe për marrëdhëniet Kosovë- Serbi në raport me integrimin e të dy vendeve për në BE.



“Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë, përndryshe nuk ka zhvillim. Zhvillimi ekonomik do të shtyjë procesin e pajtimit mes dy vendeve”, vlerësoi diplomatja gjermane.

Ajo tha se BE-ja nuk do të pranojë vende që nuk i kanë zgjedhur problemet e tyre. “Në konferencën për Ballkanin Perëndimor, shumica e vendeve nuk kanë pasur shpresë për ndonjë arritje

dhe nuk kanë dhënë ndonjë rezultat konkret, mirëpo unë mendoj se ka qenë shumë e suksesshme, pasi që është inkurajuar bashkëpunimi sidomos mes Bosnjës dhe Serbisë, të cilat kanë pasur një projekt të përbashkët për t’u financuar nga BE-ja. Gjithashtu edhe Shqipëria ka shënuar një progres këtë vit, pas vizitës së kryeministrit Rama në Beograd”, u shpreh ambasadorja gjermane.

Në këtë ligjëratë, ambasadorja Viets ka folur për rolin e Gjermanisë në vendet e

Ballkanit si dhe misionet në Kosovë, që nga koha e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në vitin 1999, më pas roli i saj në OSBE dhe së voni edhe në misionin e EULEX-it.

Duke folur për ndihmat dhe fondet për zhvillimin e vendeve të Ballkanit, nga të cilat, shumica vijnë nga Gjermania, ajo thotë se “Ne kemi qenë shumë aktivë në Ballkanin Perëndimor dhe kemi kontribuar shumë me fonde së bashku me vendet e tjera të BE-së”.

Sipas saj, prioriteti parësor i Qeverisë së Kosovës për vitin

2015 duhet të jetë zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia e qytetarëve.

Në fund të kësaj ligjërate u zhvillua edhe një debat, ku studentët e AAB parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj diplomatja gjermane në Kosovë, Angelika Viets.

Gjithashtu Ambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Angelika Viets ka takuar edhe menaxhmentin e lartë të AAB-së, me të cilët ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore.



Athanassiadou: Greqia nuk e përjashton mundësinë që ta njohë Kosovën



“Ne nuk e kemi njohur Pavarësinë e Kosovës, por kemi thënë që nuk e përjashtojmë mundësinë që ta njohim. Kjo është pikë që duhet ta kemi si referencë. Në mesin e pesë vendeve anëtare të BE-së, ne jemi më fleksibil”. Kështu u shpreh shefja e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë, ambasadorja

Konstantina Athanassiadou, në një ligjëratë të mbajtur për studentët e Universitetit AAB.

“Unë nuk hezitoj të them që ne, ofrojmë ndihmë teknike për çdo gjë që nevojitet. Fjalët që janë përdorur dhe po përdoren në marrëveshje e dhe kompromise sa i përket vendimeve të organ-

izmave ndërkombëtarë janë kontribut i Greqisë. Ne nuk i përfaqësojmë pesë vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Pavarësinë e Kosovës, por ndihmojmë në gjetjen e kompromiseve”, theksoi ambasadorja greke, Konstantina Athanassiadou.

Ambasadorja greke në Kosovë, ka përmendur edhe ndihmat konkrete që Greqia i ka bërë Kosovës në anëtarësimin e saj në organizatat ndërqeveritare, si:

“Në vitin 2009, ne kemi votuar që Kosova të futet në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në vitin 2011, kemi votuar që Kosova të jetë anëtare e Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (BERZH). Poashtu, në vitin 2013 e kemi përkrahur Kosovën në Komisionin e Venecias të Këshillit Evropian”, ka theksuar ajo.

Athanassiadou, gjithashtu

tha se që nga prilli, në misionin diplomatik në Prishtinë e kanë edhe sistemin e plotë të vizave Shengen, që sipas saj, kjo gjë tregon edhe një qëndrim të Greqisë ndaj Kosovës. “Kosova ka një perspektivë të qartë euroatlantike, ne e përkrahim perspektivën evropiane të saj. Kosova është vend fqinj i yni dhe jeni të mirëseardhur edhe si turistë”, tha diplomatja greke.

Lidhur me atë se çfarë e pengon Greqinë që ta njohë Kosovë, diplomatja greke theksoi se “ne nuk flasim për pengesën, ne flasim për rrugën që do ta ndjekim. Në një moment të duhur do të marrim vendimin e duhur. Kjo është një çështje që kërkon një momentum të duhur politik”.

Janë shumë faktorë që kanë të bëjnë me këtë punë, situata e brendshme politike,

rajoni, konstituimi i Qeverisë, e shumë faktorë të tjerë që imponojnë një proces që nuk është shumë i thjeshtë. Kemi një qark të mbyllur në politikën greke, është një çështje që unë do ta diskutoj me qeverinë e ardhshme greke”, u tha studentëve të Universitetit AAB, ambasadorja Konstantina Athanassiadou.

Në këtë ligjëratë me temën “Politika e jashtme e Greqisë”, Athanassiadou, foli edhe për historikun e themelimit të kombit modern grek, i cili me vitin 2021 do të festojë 200 vjetorin e lindjes.

Në fund të kësaj ligjërate u mbajt edhe një debat ku studentët e Universitetit AAB parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj ambasadorja, Konstantina Athanassiadou.

Ambasadori britanik Ian Cliff: Trepça nuk duhet të jetë temë e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit, ajo është e Kosovës

“Trepça e suksesshme mund të krijojë një mjedis ekonomik që mund të lulëzojë. Ajo që është në territor të Kosovës është aset i Kosovës. Kjo nuk duhet të jetë temë e dialogut me Serbinë, por duhet të zgjidhet brenda Kosovës. E di që nuk do të jetë e lehtë, por mendoj se kjo duhet të jetë mënyra më e mirë që të zgjidhet kjo çështje”, tha Ambasadori britanik Ian Cliff në Universitetin AAB.

“Harrojeni që ka qenë investim britanik në vitet e njëzeta dhe të tridhjeta, një shekull më parë. Nuk ka pretendime nga ana e jonë, por ne e shohim Trepçën si motor për zhvillimin e Kosovës. Ekspertë nga Britania, Norvegjia dhe Gjermania e kanë shikuar Trepçën dhe kanë vlerësuar se mund ta bëni Trepçën ndërmarrje të suksesshme, sepse mund të nxirren përqindje të mëdha të metaleve”, ka thënë ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ian Cliff, në një ligjëratë para studentëve të Universitetit AAB.

Siapas tij, problemi qëndron në atë se ka nevojë për një pastrim mjedisor për ta

ngritur në standarde evropiane.

“Nuk mund ta keni atë se si ka qenë në kohën e Titos. Nuk mendoj se Trepça duhet të jetë në duart e Agjencisë së Privatizimit. Ju duhet të lidhni pjesën veriore dhe jugore të saj, dhe të tërhiqni ndonjë partner strategjik nga Evropa apo diku tjetër”. Ambasadori Cliff tha se ka shumë iluzione në lidhje me Trepçën dhe se i duhen së paku pesë deri në dhjetë vjet një kompanie që të krijojë një profil me standarde evropiane.

Në pyetjen se nëse liria e Kosovës ka ardh si rezultat i gjakut boshnjak dhe kroat, dhe idesë së Ibrahim Rugov-

ës për ta shmangur luftën në atë kohë, në fillim të viteve 1990, ambasadori Cliff u përgjigj, që kjo është një çështje delikate që ta thotë para medieve, por ai tha se është e sigurt që situata do të kishte qenë shumë më e ndryshme dhe me gjasë do të kishte marrë më shumë viktima në Kosovë.

Duke folur për perspektivën e Kosovës, ambasadori Cliff tha se në aspektin afatgjatë, Kosova do të jetë pjesë e BE-së, NATO-s.

Në këtë ligjëratë, ambasadori Cliff foli edhe për rrugën e gjatë të komb-ndërtimit anglez dhe u fokusua në pikat kyçe të këtij procesi, duke thënë se i kombit an-



glez ka qenë më i lehtë se sa i kombeve të tjera falë gjeografisë. Për këtë temë, paraprakisht foli edhe profesori i lëndës N. Spahiu.

Gjithësehtu, ambasadori britanik foli edhe për Konferencën e Londër pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, ku konfirmoi se kjo konferencë ka qenë ajo që e ka themeluar shtetin shqiptar, dhe se kur është bërë kjo janë marrë parasysh shumë interesa.

Këto teza ishin disa prej më interesanteve për të cilat foli ambasadori Ian Cliff gjatë ligjëratës në Universitetin AAB, në lëndën “Politika e jashtme” të prof. dr. Nexhmedin Spahiu, ku u trajtua politika e jashtme britanike. Në fund të ligjëratës u zhvillua edhe më tej një debat ku studentët e AAB-së parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj ambasadori britanik Cliff.

Diplomati Scott Lang: SHBA-të synojnë integrimin e gjithë kombeve ballkanike në NATO, përfshirë Kosovën dhe Serbinë

“SHBA-të synojnë integrimin e gjithë kombeve ballkanike në NATO, përfshirë Kosovën dhe Serbinë” kështu deklaroi diplomati amerikan Scott Lang, para studentëve të Fakultetit Shkencë Politike dhe Diplomaci të Universitetit AAB, si mysafir-ligjërues në temën “Politika e jashtme amerikane”.

Ai potencoi se SHBA-të po e përcjellin me vëmendje dialogun ndërmjet Kosovës e Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe se SHBA-të përkrahin anëtarësimin në Bashkimin Evropian të të gjitha kombeve ballkanike. Lang përmendi se Kroacia para se të bëhej vend anëtar i BE-së u anëtarësua në NATO së bashku me Shqipërinë dhe se vendi i tij ka raporte të mira Serbinë, edhe në nivelin ushtarak.

Diplomati Scott Lang iu shmang përgjigjes direkte në pyetjen e një studenti, nëse Ameri-

ka përkrahë apo jo kërkesën e serbëve që Asociacioni i Komunave Serbe të ketë kompetenca ekzekutive, duke thënë se SHBA-të do të pranojnë marrëveshjet që i nënshkruajnë të dyja qeveritë, duke nënkuptuar këtu qeveritë, e Kosovës dhe Serbisë. Lang u pajtua me hyrjen e profesorit të lendes, Nexhmedin Spahiu se Amerika është një komb i ndërtuar mbi vlera të larta morale me vetë faktin se katër themeluesit e kombit amerikan: George Washington, John Adams, Thomas Jefferson e James Madison nuk e eliminuan njeri tjetrin por secilit i erdhi radha të bëhej president i Amerikës. Pikërisht ky fakt ka bërë që kombi amerikan të jetë kombi më i fuqishëm i botës.

Diplomati Scott Lang në fund është përgjigjur edhe në një varg pyetjesh të shtruar nga studentët e AAB-së.



Ambasadori norvegjez Jan Braathu: Shqipëria dhe Kosova - dy vëllezër që jetojnë në shtëpi të ndara



Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jan Braathu, i cili njëkohësisht ushtron këtë detyrë edhe në Shqipëri, në një lig-

jëratë për studentët e Universitetit AAB, komentoi deklaratat e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për bashkimin Kosovë-

Shqipëri, duke thënë se është i mendimit të ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili pati thënë se “Jemi dy vëllezër,

por jetojmë në shtëpi të ndara”.

“Në momentin që Kosova do t’i bashkohet Shqipërisë, mendoj se Prishtina nuk do të jetë kryeqytet i Shqipërisë së Madhe. Nuk besoj se Kosova do të jetë në qendër të aktiviteteve. Nuk besoj se Kosova do të jetë pjesë e politikave funksionale të Shqipërisë së Madhe. E më pas do të linte problemi mes Jugut dhe Veriut të Shqipërisë, kështu që mendoj se qasja e Ibrahim Rugovës e shpjegon më së miri këtë gjë”, u shpreh ambasadori norvegjez Braathu.

Sa i përket rolit të Norvegjisë në çlirimin e Kosovës në Luftën e fundit, ambasadori Braathu, tha se Norvegjia ka qenë e angazhuar në procesin e Kosovës që nga vitet ‘80-ta e deri në vitin 1999, por edhe më pas. Ky shtet ka qenë ndër shtetet që i ka dhënë më së shumti ndihma Kosovës.

Ambasadori norvegjez në këtë

ligjëratë foli edhe për protestat që do të mbahen nesër të organizuara nga opozita, duke thënë se është e drejtë demokratike që të protestohet, por ato të jenë të qeta dhe të mos përsëriten skenat nga protestat e fundit që ishin në Kosovë.

Ambasadori Braathu gjatë ligjëratës studentëve u foli edhe për historikun e shtetëformimit norvegjez, për referendumin dhe monarkinë kushtetuese, si dhe shkaqet që çuan këtë shtet të refuzojë me referendum të hyjnë në Bashkimin Evropian, proces ky që ende është temë në Norvegji. Në fund të kësaj ligjërate, u zhvillua edhe një debat, ku studentët e Universitetit AAB parashtruan pyetje, të cilave iu përgjigj ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jan Braathu.

Ambasadori malazez, Miljaniq: Nuk duam ta marrim asnjë metër territor të Kosovës

Në vazhden e vizitave të njëpasnjëshme të ambasadorëve të akredituar në Kosovë, sot Universitetin AAB e vizitoi ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, z. Radovan Miljaniq.

Gjatë takimit me studentët e AAB-së, ambasadori malazez ka folur për shtetin që e përfaqëson dhe marrëdhëniet diplomatike të vendit të tij në raport me Kosovën dhe me vendet e tjera. Ndër të tjera, ai nuk ka lënë pa përmendur edhe çështjet e aktualitetit me të cilat ballafaqohen shoqëritë tona.

“Me Kosovën dhe me të gjithë fqinjët tjerë, ne duam të kemi raporte të mira fqinjësore”, ka thënë ai. “Ne nuk duam të marrim asnjë metër territor të Kosovës. Marrëveshjen e 19 Prillit mes Kosovës e Serbisë në Bruksel e konsiderojmë gurëthemel të pajtimit shekullor mes shqiptarëve dhe serbëve”, ka theksuar ambasadori Miljaniq.

Ai po ashtu tha se koha kur Mali i Zi, Kosova, Shqipëria e Maqedonia

do të kenë ambasada e konsullata të përbashkëta nuk është e largët.

Duke folur për Gjykatën Speciale, ka thënë se Kosova duhet të ballafaqohet me të kaluarën dhe se krimet duhet të dënohen. “Unë, si diplomat i huaj nuk do të vendos në cilëndo anë. Udhëheqësja e Kosovës është e mençur dhe do ta gjejë zgjidhjen e drejtë. Nuk jam as në anën e pushtetit e as në anën e opozitës, por do ta them mendimin tim. Pa ballafaqim të plotë me të kaluarën, nuk do të ketë përparim për Kosovën. Secili krim është krim, dhe ai meriton drejtësinë dhe dënimin. Kosova do të dalë nga kjo sigurisht. Ka pasur gjëra më të vështira dhe Kosova i ka tejkaluar”, është shprehur Ambasadori i Malit të Zi në Prishtinë, Radovan Miljaniq.

Ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Radovan Miljaniq, në fund është përgjigjur edhe në një varg pyetjesh të shtruar nga studentët e AAB-së.



Studentët e Fakultetit Juridik realizuan vizitë studimore në Prokurorinë Themelore të Prishtinës



Studentët e Fakulteti Juridik të AAB-së, të shoqëruar nga mësimdhënësja Ganimete Ismaili, realizuan një vizitë studimore në Pallatin e Drejtësisë, përkatësisht në Prokurorinë Themelore të Prishtinës. Studentët u pritën nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka dhe prokurorët e administratorët e këtij institucioni, të cilët i kanë njoftuar stu-

dentët për procedurat dhe funksionimin e Prokurorisë në fjalë dhe sfidat profesionale me të cilat ballafaqohen. Studentët u ndanë të kënaqur me realizimin e kësaj vizite me karakter studimor, duke u shprehur se nga tani e kanë shumë më të lehtë t'i konceptojnë ligjëratat e zhvilluara nga teoria, sepse nga afër kanë parë se si zbatohen ato në praktikë.

Studentët e AAB: Rruga e Kosovës për në BE – si një labirinth

Kosova nuk ka rrugë tjetër përveç asaj të integritetit në strukturat e Bashkimit Evropian – është përfundimi që del qartë nga të gjitha aktivitetet, e që ishin të shumta, të organizuara sot në Prishtinë me rastin e Ditës së Evropës, 9 Majit.

Por, kjo rrugë nuk është dhe aq e drejtë dhe e lehtë, porse paraqet një labirint të vërtetë dhe këtë, me një aktivitet më të veçantë, edhe vizualisht e treguan studentët e Universitetit AAB. Ata, përmes një labirinti të ndërtuar te Sheshi “Zahir Pajazi”, dëshmonin për atë se sa e vështirë është lëvizja e qytetarëve të Kosovës në BE dhe se sa shumë kriteret duhet plotësuar për t'u anëtarësuar në familjen evropiane.

Studentët po sfidonin qytetarët që të ecnin në labirintin e paraqitur, me çka ilustruan numrin e madh të kriterëve që Kosova ka përmbushur dhe që duhet të plotësojë për të marrë liberalizimin e vizave.

Sipas studentes së Departamentit të Shkencave Sociale në këtë universitet Antigona Retkoceri, Kosova, megjithëse një vend i vogël, po i duhet të plotësojë kriteret shumë të mëdha.

Ndërsa profesoresha Alberita Bytyqi tha se Kosova po përballet me barrierat e shumta për t'u integruar në BE dhe për t'u bërë pjesë e saj.

Në anën tjetër, Rrahim Rexhepi, një qytetarë i cili provoi labirintin e shfaqur në mënyrë simbolike nga studentët e AAB-së, tha se kalimet dhe kthesat që ai i kaloi ishin të mundshme, çka sipas tij dëshmoi se çdo

kthesë ka sakrificën brenda vetës, e cila duhet bërë për të hyrë në BE.

Dita e Evropës - 9 Maji është njëra ndër Festat Zyrtare në vend. Kjo festë ditë më parë në Kuvendin e Kosovës është kërkuar të hiqet si ditë pushimi në mesin e festave zyrtare, dhe po ashtu është kërkuar që pushimi për këto ditë të mos bartet në ditë të tjera në rast se bie gjatë fundjavës si kësaj radhe. Mirëpo, kjo nuk ka marrë votat e mjaftueshme nga ana e deputetëve, kështu që prapë institucionet shtetërore e publike do të pushojnë të hënë. <http://www.kosovapress.com/>



20 studentë të përzgjedhur, pjesë e sistemit tutorial të AAB-së gjatë semestrit veror 2014/15

Krahas aktiviteteve të vazhdueshme në përputhje me planprogramin universitar, në fillim të semestrit veror është përmbyllur konkursi për përzgjedhjen e studentëve tutorë, gjatë vitit akademik 2014/15. Tutorët studentë, janë përzgjedhur në të gjitha programet e studimit që organizohen në të tre kampuset e Universitetit AAB në Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj.

Sistemi tutorial në Universitetin AAB ka për qëllim përfaqësimin e studentëve nga vet studentët.

Rëndësia e studentëve tutorë është shumë e madhe ngase këta studentët tutorë e bëjnë fuqizimin e trekëndëshit: student – profesor – menaxhment apo administratë – student.

Po ashtu rëndësia e sistemit tutorial të studentëve është që të bëhen ndryshime në të mirën e universitetit dhe në të mirën e studentëve. Tutorët mund t' i ndihmojnë studentëve në vështirësitë e tyre akademike duke i përfaqësuar studentët dhe duke i ndihmuar ata, apo me fjalë të tjera, duke i shfaqur kërkesat dhe sugjerimet e tyre për përmirësime dhe duke iu ndihmuar me ngecje akademike.




Elbasan Hamiti
Kulturë Fizike dhe Sport



Alban Lahu
Shkenca Kompjuterike



Besart Kolgeci
Juridik i Përgjithshëm



Valon Demiri
Administratë Publike



Behare Pllana
Shkenca Sociale




Agnesa Balaj
Gjuhë Angleze




Mirjeta Hajzeraj
Komunikim Masiv



Valon Bislimi
Ekonomik



Blerina Zogaj
Ekonomik



Valmir Sadiki
Ekonomik




Yllka Qarri
Arkitekturë




Bardhyl Dobroshi
Arte




Sebina Kadriu
Juridik




Liridon Gabrrica
Ekonomik



Agnesa Maloku
Shkenca Sociale




Rrezarta Ramadani
Gjuhë Angleze



Valbona Shabani
Administratë Publike



Marigone Deda
Juridik



Afërdita Zeneli
Ekonomik



Zana Nura
Gjuhë Angleze

Seida Suma, u zgjedh kryetare e Unionit Studentor të AAB-së


Në një proces korrekt zgjedhor, është zgjedhur kryesia e re e Unionit Studentor të AAB-së. Kryesia e re e US-AAB, do të jetë në këtë përbërje: Kryetare u zgjedh studentja Seida Suma nga Fakulteti Ekonomik, nënkryetare Gentiana Spahiu nga Fakulteti i Muzikologjisë, nënkryetar Florent Ramaj nga Fakulteti i Administratës Publike dhe sekretar i përgjithshëm Besart Vishesella nga Fakulteti i

Shkencave Kompjuterike.

Po ashtu u zgjedhën edhe përfaqësuesit e kryesisë nga degët e AAB-së në Ferizaj e Gjakovë, ku dega e Ferizajt do të përfaqësohet nga Drilon Haxhiu, student i Fakultetit të Administratës Publike, ndërsa kampusin e Gjakovës do ta përfaqësojë Shqiponja Deda nga Fakulteti Juridik.



Seida Suma



Gentiana Spahiu



Florent Ramaj



Besart Vishesella



Drilon Haxhiu



Shqiponjë Deda

AAB vazhdon bashkëpunimin me institucionet arsimore të Republikës së Turqisë

Në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar, një delegacion nga institucioni arsimor "Final" i Republikës së Turqisë, në krye me themeluesin e saj, z. Zeki Cobanoglu, vizituan Universitetin AAB, me qëllim të shqyrtimit të mundësive për fillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjatë takimeve u diskutuan mundësitë e studimeve për studentët e interesuar nga Turqia.

Delegacioni i bëri një vizitë edhe kampusit universitar në Prishtinë, dhe u shpre-

hën të impresionuar me me të arriturat dhe kushtet që ofrohen në AAB.

Institucioni arsimor "Final" është themeluar para afër tri dekadave dhe gëzon një respekt të madh në vend dhe tek partnerët ndërkombëtar. "Final" është ndër institucionet më prestigjioze për përgatitjen e nxënësve për arsim universitar, në Republikën e Turqisë dhe ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi edhe me universitete të tjera.



AAB bashkëpunon edhe me Drejtorinë Komunale të Administratës në Ferizaj

Drejtori i Degës së AAB-së në Ferizaj, Medain Hashani, në një takim me drejtorin e Drejtorisë Komunale për Administratë në Komunën e Ferizajt, Naim Feratin, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimi i mundësisë për studentët e AAB-së, për të mbaruar mësimin praktik në Drejtorinë Komunale të Administratës në Ferizaj, në sektorin e administratës. Marrëveshja parasheh që institucionet nënshkruese të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë në mënyrë të përbashkët edhe pikat tjera si: të përkrahin dhe të ngrisin nivelin e bashkëpunim-

it reciprok në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë; realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përmirësimin e ambientit ekonomik dhe social në Kosovë; si dhe hartimin e analizave të kërkimit të tregut.

Palët nënshkruese të të dyja institucioneve pas nënshkrimit të marrëveshjes kanë thënë se, ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.



Kryetari i KPM-së, Adnan Merovci: Jemi vonë me digjitalizimin në Kosovë



“Data e përcaktuar si e fundit 17 qershor 2015 nuk mundet të arrihet nga Kosova dhe nga shtetet fqinje, në procesin e digjitalizimit të përmbajtjeve audio-vizuale në Kosovë. Kjo, sepse në Kosovë ende nuk është miratuar Ligji për Digjitalizimin, i cili do t’i hapte rrugë këtij procesi të rëndësishëm për kalimin e transmetimit tokësor analog në atë digjital”, kësh-tu ka thënë para studentëve të Fakultetit të Komunikimit Masiv, kryetari i KPM-së, z. Adnan Merovci.

Megjithatë, Merovci vlerëson se KPM ka kryer punën e vet, rreth hartimit të strategjisë për digjitalizimin, dhe pavarësisht vonesave, as vendet e BE-së, të cilat e kanë përfunduar këtë proces, nuk kanë arritur që të jenë në përputhje me kohën.

Në këtë ligjëratë informuese për procesin e digjitalizimit, Merovci ka shpjeguar se strategjia për digjitalizim përcakton në mënyrë të gjithanshme procesin e kalimit të transmetimit televiziv tokësor analog në transmetim tokësor digjital. Në këtë proces janë të përfshira të gjitha palët e interesit (industria mediale, institucionet përkatëse shtetërore, shoqëria civile etj. Z. Merovci shtoi se strategjia për digjitalizim në mënyrë të qartë përcakton drejtimit strategjike zhvillimore, obligimet dhe afatet kohore të kalimit të transmetimit tokësor analog në atë digjital, në pajtim të plotë me standardet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-së) dhe të Komisionit Evropian.

“Transmetimi televiziv digjital

do t’iu ofrojë qytetarëve të Republikës së Kosovës cilësi më të mirë të pranimit të sinjalit televiziv, kapacitet më të madh për shumëllojshmëri të ofrimit të përmbajtjeve programore, më shumë programe televizive, shërbime të reja për përdoruesit me nevoja të veçanta dhe për të moshuarit, shërbime shtesë, pranim portativ dhe mobil (në lëvizje) të programit si dhe konvergencën e shërbimeve mediale dhe telekomunikuese”, tha z. Merovci, duke shtuar se digjitalizimi sjell mundësi të reja për ofruesit e shërbimeve që të ofrojnë përmbajtjen e programit sipas nevojave të grupeve të caktuara të shoqërisë kosovare, ofron inter-aktivitet, ofron mundësi për shërbime sipas kërkesës dhe, mbi të gjithë,

tha, përbënë kosto më të ulët të transmetimit në përgjithësi.

Gjithashtu z. Merovci tha se publiku i gjerë do të përfitojë nga përdorimi më efikas i spektrit frekuencor, shfrytëzimi i dividendës digjitale të spektrit për implementimin teknologjik të shërbimeve të reja, promovimi i zhvillimit të teknologjisë dhe mundësive të reja krijuese nga konkurrenca e përmirësuar, mundësi për zgjerim të kreativitetit në kuptimin e ofrimit të shërbimeve si dhe ruajtjen e identitetit kulturor.

Ai numëroi të mirat që i sjellë digjitalizimi si përmirësimi i shfrytëzimit të spektrit frekuencor, përmirësimi i pranimit të sinjalit, shtimi i kanaleve televizive, kostoja e transmetimit më e lirë, formati i ri i fotograf-

isë dhe shërbime të reja, etj.. Digjitalizimi nuk duhet të dëmtojë tregun dhe pluralizmin medial në Kosovë.

Strategjinë e harton KPM-ja dhe e dërgon në qeveri për aprovim, pastaj hartohet Ligji për Digjitalizim në bazë të të cilit implementohet digjitalizimi.

Gjithashtu, Merovci foli edhe për historiatin, menaxhmentin, rolin dhe funksionin e KPM-së, si organi më kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës.

Në fund të kësaj ligjëratë u zhvillua edhe një debat, ku studentët e AAB parashtruan pyetje të cilave iu përgjigj kryetari i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), Adnan Merovci.



Me kërkesë të Institutit për Administratë Publike, AAB vazhdon të trajnojë zyrtarët e lartë administrativ

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin për Administratë Publike, stafi akademik i Fakultetit të Administratës Publike në AAB, kanë mbajtur një trajnim profesional për stafin e lartë udhëheqës të institucioneve administrative të Kosovës. Trajnimi “Kontrolli i efikasitetit të Administratës Publike në Kosovë” ka ndihmuar zyrtarët e lartë administrativë në krijimin e një pasqyre të qartë lidhur me format e kontrollit mbi administratën; të identifikohen faktorët që janë duke ndikuar në ngathtësinë e kontrollit mbi

administratën; analizimi i bazës ligjore për ushtrimin e procesit të kontrollit në administratë; janë prezantuar praktika të mira të ushtrimit të kontrollit mbi administratën.

Avni Alidemaj, mësimsdhënës në AAB, njëri nga pjesëmarrësit në këtë projekt në cilësinë e trajnuesit, tha se trajnimi është pritur pozitivisht nga zyrtarët administrativë sepse ka ndihmuar në identifikimin e sfidave dhe ushtrimin profesional të procesit të kontrollit e që në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon në ngritjen e efikasitetit

të administratës publike.

Pjesëmarrësit në trajnim do të jenë në gjendje të ndikojnë si katalizatorë të reformës së administratës duke kontribuar thelbësisht në ofrimin e shërbimeve më të mira qytetarëve dhe zbatimin e parimeve bashkëkohore demokratike në veprimtarinë e tyre.




Studenti i AAB-së, Alket Rexhepi, pjesëmarrës në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare OSCAL 2015

Alket Rexhepi, student i Shkencave Kompjuterike në Universitetin AAB, do të marrë pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare OSCAL 2015 (Open Source Conference Albania).

Ai do të prezantohet me temën "Zhvillimi i video - lojërave me vegla të hapura".

Punimet e konferencës do të zhvillohen nga data 9 deri më 10 maj 2015, në Tiranë.

Për më shumë informacione rreth konferencës vizitoni faqen e konferencës: <http://oscal.openlabs.cc/>



Stafi akademik i AAB-së pjesë e punëtorisë ICE-ASSORESTAURO në Itali

Shyqri Nimani, Fitim Aliu dhe Bujar Demjaha, mësime të rregullt në Fakultetin e Arteve dhe Arkitekturës të AAB-së, kanë marrë pjesë në punëtorinë ICE-ASSORESTAURO- Training and commercial visit to Italy for Foreign Architects and Restorers, të organizuar nga Qeveria e Italisë në bashkëpunim me Agjencinë Italiane të Tregtisë (ITA).

Mësime të AAB-së ishin të vetmit që e kanë përfaqësuar Republikën e Kosovës në këtë aktivitet, punimet e së cilit zgjatën për një javë me radhë.



AAB- Ferizaj vazhdon bashkëpunimin me Postën e Kosovës

Drejtori i Degës së AAB-së në Ferizaj, Medain Hashani, në një takim me Kryeshefin Ekzekutiv të Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, kanë nënshkruar marrëveshjen për vazhdimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimi i mundësisë për studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit AAB, dega në Ferizaj, për

të mbaruar mësimin praktik në Postën e Kosovës në regjionin e Ferizajt, në këto komuna si Ferizaj, Kaçaniku, Hani Elez, Shtime dhe Shtërpca. Marrëveshja parasheh që institucionet nënshkruese të bashkëpunojnë dhe të zbatojnë në mënyrë të përbashkët edhe pikat tjera si: të sigurojnë programe të përbashkëta hulumtuese, verifikimi i inici-

ativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në fushën e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, si dhe aktivitete tjera në interes të përbashkët. Sipas palëve nënshkruese, ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

U shënua dita e arsimit në gjuhën amtare



Në Universitetin AAB, sot është mbajtur aktiviteti "Dita e arsimit në gjuhën amtare", i cili është organizuar nga Universiteti AAB në bashkëpunim me EROL dhe TLP (Programi efektiv i sundimit të ligjit dhe programi transformues i lidershit-program që mbështetet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe USAID). Tema kryesore për të cilën është diskutuar në këtë aktivitet ishte: "Çështje të arsimit dhe përdorimit të gjuhës amtare, si dhe mundësitë e shkollimit jashtë vendit për pjesëtarët e pakicave kombëtare".

Përveç studentëve, pjesëmarrës në këtë aktivitetin ishin edhe përfaqësuesit më të lartë të institucioneve organizatore.

Në hapje të aktivitetit, prorektori për Çështje Ndërkombëtare, Xhavit Rexhaj falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, si dhe të bashkorganizatorët e këtij aktiviteti, dhe ka folur për rëndësinë e mësimin në gjuhën amtare dhe përpjekjet e kosovarëve për ta realizuar këtë të drejtë gjatë historisë. "Janë pikërisht përvojat e shqiptarëve të Kosovës me mësimin në gjuhën amtare që kanë bërë që në AAB ta çojmë më shumë këtë të drejtë të komuniteteve në Kosovë. Prandaj AAB-ja ka filluar implementimin e programit të studimeve në Fakultetin Juridik në Gjuhën Boshnjake dhe në atë Malazeze", ka thënë ai.

Po ashtu prorektori Rexhaj, ka paralajmëruar se pas fillimit të suksesshëm të këtij programi do të fillojë edhe implementimi i studimeve në gjuhën turke dhe në atë angleze në disa fusha të studimit.

Slavisha Mlladenoviq, komisionar për Gjuhët në Zyrën e Kryeministrit ka bërë një prezantim të punës së kësaj zyre në implementimin e Ligjit për Gjuhët në Kosovë dhe për

sigurimin e barazisë së gjuhëve në Kosovë.

Në fjalën e tij ai ka treguar praktika të mira dhe angazhimet konkrete të zyrës në drejtim gjithnjë duke marrë shembuj konkret nga puna e përditshme e zyrës që ndërlidhen me profesionin e ardhshëm të studenteve të pranishëm të Fakultetit Juridik.

Në fund, porositja e Mlladenoviqit për studentët ishte që gjithnjë dhe pa dallim t'i zbatojnë të gjitha ligjet dhe në veçanti ato që sigurojnë barazinë në mes të qytetarëve të Kosovës të të gjitha komuniteteve. Po ashtu edhe Visar Morina, këshilltar ligjor, USAID/EROL, foli për udhëzimet e propozuara për shqyrtimin e ligjeve të miratuara nga ana e zyrës së Presidentit, e në fakt udhëzime që i ndihmojnë Zyrës së Presidentit t'i identifikojnë ligjet që meritojnë më shumë vëmendje gjatë shqyrtimit dhe që paraqesin potencialin me të madh për t'iu kthyer Kuvendit.

Kurse Mark Baskin, drejtor i programit USAID/TLP-SP, programi transformues i lidershit - Bursa dhe Partneritete Program i USAID-it për zgjerim të arsimit të lartë në bashkëpunim me universitete të Kosovës, i njoftoi studentët e AAB-së, për kriteret e aplikimit në fushat e caktuara studimore, kanë dhënë detaje të hollësishme deri te përfitimi i kësaj burse, akomodimin e tyre në SHBA dhe për përfitimet e tyre pas mbarimit të studimeve. Ai ka bërë me dije se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e AAB-së, të cilët i përfundojnë studimet e nivelit bachelor e të cilët flasin gjuhën angleze.

Diskutuesit në fund janë përgjigjur edhe në një varg pyetjesh të shtruar nga studentët e AAB-së.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë

Ministri Veliaj në AAB: Marrëveshje konkrete në të mirë të qytetarëve në Kosovë e në Shqipëri

“Një prej tyre ka qenë marrëveshja për lejet e punës. Një shqiptari nga Shqipëria që punon në Kosovë, apo një shqiptari nga Kosova që punon në Shqipëri i duhen mesatarisht tre muaj që të nxjerrë lejen e punës. Është një burokraci totalisht e panevojshme. Në një treg pune me pesë milionë banorë është më lehtë që gesh punë sesa në një vend me dy, ose me tre milionë banorë. Ngase tregu i punës është i gjerë nga Mitrovica deri në Gjirokastrë”, ka thënë ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Shqipëri, Erion Veliaj gjatë një ligjëratae për studentët e Universitetit AAB.

“Shqipëria sot nuk njihet si e fundit në rajon, por njihet një nga vendet dhe udhëheqjet më progresiste në rajon. Besoj që është lajm i mirë që sot Shqipëria eksporton emancipim, ku shtatë kolege të mia, ministre, janë vajza dhe gra. Besoj që është e paprecedent për rajonin tonë, por edhe për shqiptarinë në përgjithësi ky nivel emancipimi dhe besoj që në këtë nivel, ne jemi avangardë”, deklaroi ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Shqipëri, Erion Veliaj gjatë një ligjëratae për studentët e Universitetit AAB.

Ministri Veliaj tha se beson që Shqipëria dhe shqiptarët në rajon janë eksportues të paqes dhe janë ndoshta arsyeja kryesore pse ka paqe në rajon, sepse është vullneti i lidërsipit shqiptar, këndej dhe andej kufirit për të qenë një faktor stabilizues në vend.

Ministri Veliaj në këtë ligjëratae me studentët e Universitetit AAB foli edhe për punën e ministrisë që ai drejton duke

thënë se Shqipëria shpenzon sot më shumë në fondin e saj social për personat me ndihmë ekonomike, në fond papunësie dhe personave me aftësi të kufizuara se sa çdo vend tjetër per kapita, apo përqindje të GDP-së në rajon.

Ai tha ndër të tjera se nuk ka ardhur në Kosovë të flasë për gjërat politike: “Shqipëri-Kosovë, vëllai i im, vëllai i yt, ja ku jemi”, por për gjëra konkrete që kanë impakt te jeta e njerëzve.

“Një prej tyre ka qenë marrëveshja për lejet e punës. Një shqiptari nga Shqipëria që punon në Kosovë, apo një shqiptari nga Kosova që punon në Shqipëri i duhen mesatarisht tre muaj që të nxjerrë lejen e punës. Është një burokraci totalisht e panevojshme. Në një treg pune me pesë milionë banorë është më lehtë që gesh punë sesa në një vend me dy, ose me tre milionë banorë. Ngase tregu i punës është i gjerë nga Mitrovica deri në Gjirokastrë”, tha ai

Marrëveshja tjetër, vazhdon ai,



që kanë bërë me Kosovën kanë qenë me qendrat e formimit profesional ku për herë të parë të gjithë qytetarët e Kosovës që punojnë në Shqipëri apo që jetojnë në Shqipëri mund të trajnohen në qendrat tona të aftësimi profesional dhe anasjelltas.

“Kjo është veçanërisht e nevojshme për disa zona depresive ekonomike që ne kemi. Psh. Zona e Kukësit është me 40 për qind të njerëzve që janë me ndihmë ekonomike, me papunësi të theksuar dhe në pamundësi që shteti shqiptar të investojë disa miliona euro

në qendrën e aftësimi profesional, shumë kollaj, Kukësi, Tropoja dhe Hasi mund të përdorin aksesin që kanë, falë kësaj marrëveshje, në Gjakovë dhe në Prizren. Shqipëria po përgatitet për një projekt shumë të madh, është projekti “TAP” që do të sjellë gazin nga Azerbajxhani nëpërmjet Shqipërisë për në Itali, ku Shqipëria do të duhej të rekrutojë mijëra saldatorë dhe prej shumë këtyre zonave me papunësi, marrja e një zanati të tillë në Gjakovë apo në Prizren ose edhe stafeve që do të vijnë për të punuar nga Kosova është një mundësi fantastike ekono-

mike që ne duhet ta shfrytëzojmë nga tani deri më 2020 që do të jemi pjesë e këtij projekti”, theksoi Veliaj.

Ministri Veliaj gjatë qëndrimit të tij në Universitetin AAB, i shoqëruar edhe me Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, QemalMinxhozi, mbajti takim edhe me rektorin e këtij universiteti, z. LulzimTafa, me të cilin biseduan për bashkëpunimin ndëruniversitar Kosovë-Shqipëri dhe përgatitjen e kuadrove të reja për tregun e punës.



Selim Ibraimi ligjëratë para studentëve të Fakultetit Ekonomik

Selim Ibraimi, magjistër i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Amerikan Webster, ka mbajtur një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit AAB- dega në Ferizaj, mbi karakterin dhe vështirësitë

e lidërshiptit në shekullin e XXI. "Kaosi, konflikti dhe guximi janë një ndër tre karakteristikat që e bëjnë një lider të suksesshëm apo të dështuar", ka thënë ndër të tjera Ibraimi.



FOTOLAJM



Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, spontanisht u grupuan para Universitetit AAB, për të parë eklipsin e diellit, me një pajisje shumë të thjeshtë-

kamera me vrimë, e cila paraqiti një atraksion të vërtetë për studentët. Të pranishëm ishin edhe disa nga stafi akademik i këtij fakulteti.

Albanian ICT Awards 2015 u prezantua për studentët e AAB-së



Përfaqësuesit e Albanian ICT Awards mbajtën prezantimin në AAB për motivimin e studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, për të marrë pjesë në këtë garë me projektet e tyre nga fusha e informatikës. Albanian ICT Awards, është ngjarje mbarëkombëtare që vlerëson individët dhe të arriturat individuale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komuni-

kimit, thane përfaqësuesit e kësaj nisme. Ata theksuan se ky është konkurs, objektivi kryesor i të cilit është identifikimi dhe shpërblimi i profesionistëve të shquar, udhëheqësve të suksesshëm, inovatorëve, profesionistëve dhe yjeve në ngritje të cilët me kontributin e tyre kanë lënë gjurmë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këtë vit gara është e hapur

në shtatë kategori të cilat janë:

ICT Inovacioni i vitit,
ICT Akademiku i vitit,
ICT Mobiliteti i vitit,
ICT Diploma e vitit,
ICT Ylli në ngritje i vitit, dhe
ICT Shërbimi Publik më i mirë i vitit.

Ky prezantim u realizua në dy termine, para dhe pasdite, ku përveç studentëve morën pjesë edhe anëtarë të stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të AAB-së, të cilët folën për të arriturat dhe punën që po bëhet në këtë fakultet, ndërsa i inkurajuan studentët që të aplikojnë.

Gjithashtu interesimi i studentëve të AAB-së për garën në fjalë ishte i jashtëzakonshëm.

Informata shtesë në lidhje me aktivitetin në fjalë mund të gjenden në: www.ictawards.org



Studentët e Kriminalistikës vizituan Laboratorin e Forenzikës

Studentët e Fakultetit Juridik, drejtimi Kriminalistikë, të shoqëruar nga mësimdhënësit Artan Fejzullahu dhe Ganimete Ismaili, realizuan një vizitë studimore në Laboratorin e Forenzikës, në Prishtinë.

Ata u njoftuan së afërmi me punën profesionale që kryhet në këtë laborator.



Studentet e AAB-së shënuan Ditën Ndërkombëtare të Poezisë me fëmijët e Kopshtit “Bardha”

Me rastin e 21 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, Fakulteti i Shkencave Sociale i Universitetit AAB, organizoi aktivitet me disa studente të programit “Kujdesi dhe Mirëqenia e Fëmijëve”. Aktiviteti kishte karakter edukativ dhe u zhvillua në Kopshtin e Fëmijëve “Bardha” në Prishtinë, me fëmijë të moshës 4- 5 vjeç.

Me angazhimin e tyre, studentet e AAB-së dëshmuar përgatitjen e tyre duke evidencuar kështu angazhimin dhe përkushtimin aktiv të Fakultetit të Shkencave Sociale për përgatitjen e tyre, e cili u koordinua nga prof. Alberita Bytyqi.

Fëmijët dhe edukatorët e Kopshtit “Bardha”, u ndanë të kënaqur nga ky organizim i studenteve të AAB - së. Drejtoresha e Kopshtit, znj.



Gëzime Rexhepi - Çollaku u shpreh shumë e kënaqur me aktivitetin dhe shprehu interesimin e saj që ky bashkëpunim të vijojë edhe në të ardhmen, ndërkohë që siguroi se studentet e AAB-së, do të kenë mundësi të krye-

jnë praktikën profesionale në këtë institucion. Në fund të këtij aktiviteti, studentet e AAB-së i shpërblyen fëmijët me nga një fletore të Universiteti AAB.

Studentët e AAB-së u prezantuan në Forumin Ekonomik Studentor të organizuar nga Universiteti i Prishtinës

Tre studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit AAB, Egzon Thaqi, Ibadete Gashi dhe Blina Zhubi, kanë marrë pjesë në Forumin Ekonomik Studentor, forum ky i organizuar nga Universiteti i Prishtinës.

Studentët e AAB-së u prezantuan me temën “Ndikimi i shpërndarjes së buxhetit (të hyrave) në zhvillimin ekonomik të Kosovës”, temë kjo e sygjerruar nga stafi mësimdhënës i Fakultetit Ekonomik, Vjollca Hasani e Donat Rexha.

Studentët e AAB-së arritën të bëjnë një prezantim të shkëlqyer, duke dëshmuar kështu për kualitetin e stu-



dimeve dhe punën e palodhshme që bëhet në Fakultetin Ekonomik. Në këtë forum kanë marrë pjesë edhe studentët e ekonomisë të Universitetit të Prishtinës, Universitetit Amerikan në Kosovë dhe të

Kolegjit UBT. Forumi kishte për qëllim nxitjen dhe aftësimin e studentëve në sferën e komunikimit, ekonomisë, politikës dhe biznesit.

Studentët e Fakultetit Juridik vizituan Zyrat Kadastrale të Gjakovës dhe Ferizajt



Në vazhden e bashkëpunimit me institucionet e vendit, një grup i studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit AAB, dega në Gjakovë, të shoqëruar nga mësimdhënësja Enisa Haliti, kanë vizituar Zyrën Kadastrale të Komunës së Gjakovës. Ata janë pritur nga koordinatoresha Sektorit të Kadastrit të Komunës së Gjakovës, Valbone Zeka.

Një vizitë të po kësaj natyre e kanë realizuar edhe studentët e degës së Ferizajt, të shoqëruar me tutoren Sebi-na Kadriu dhe ligjëruesen e lëndës Enisa Haliti. Ata kanë vizituar Zyrën Kadastrale të Komunës së Ferizajt, dhe u pritën nga koordinatori i

drejtorisë Pronë- Kadastër-Gjeodezi, Ajet Musliu dhe nga udhëheqësi i Sektorit të Kadastrit, Zekri Bytyqi.

Studentët, si në Gjakovë ashtu edhe në Ferizaj, nga vizita dhe stafi mikpritës janë njoftuar nga afër me punën e zyrave kadastrale, rreth librit të regjistrimit për paluajtshmëri dhe fletën posedues të paluajtshmërisë.

“Kjo vizitë ka qenë një mundësi e mirë për studentët tanë që të shohin nga afër punën praktike të zyrës, që në të ardhmen të ndërli-dhin mësimin teorik me atë praktik”, tha ligjëruesja Enisa Haliti.



Marc Gruber: “Gazetaria hulumtuese duhet t’i shërbejë publikut”

Në kuadër të projektit të përbashkët të Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Projektit të Këshillit të Evropës “Duke promovuar lirinë e shprehjes dhe të informimit dhe lirinë e mediave në Evropën Juglindore”, në AAB u mbajt diskutimi për rëndësinë e gazetarisë hulumtuese, me ç’ rast ligjëroi ish-drejtori i Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG) në Bruksel, Marc Gruber.

Në diskutimin me temë “Përtej titujve të lajmeve botërore: pse është e rëndësishme gazetaria hulumtuese për interesin publik”, Gruber, foli për gazetarinë hulumtuese dhe për raportimin për të drejtat e njeriut. Ndër të tjera, ai tha se gazetaria hulumtuese nuk është diçka personale, e as heroike, ajo duhet t’i shërbejë publikut. “Gazetaria hu-

lumluese nuk bëhet vetëm. Nëse punoni vetëm jeni të rrezikuar, dhe për të bërë një gazetari të tillë nuk do të thotë domosdoshmërisht të punoni në media të mëdha”, tha Gruber.

Gruber ka dhënë shpjegime se si realizohet një storje hulumtuese dhe se si gazetari duhet t’i vihet prapa hulumtimit dhe kërkimit të informacionit. Ai iu ka sugjeruar studentëve që nuk duhet gjithmonë të synohet temat e mëdha. Në gazetarinë hulumtuese shpesh ndodh që një temë lokale të marrë përmasa të mëdha dhe të bëhet temë bosht në regjione më gjerë. Duke tërhequr paralele të të bërit gazetari hulumtuese edhe në vendet evropiane, Gruber ka sqaruar që edhe në vendet me zhvillim të lartë, gazetaria hulumtuese jo gjithmonë

përkrahet nga kompanitë e mëdha mediale, për shkak të interesave të ndryshme ekonomike.

Gruber, gjithashtu u ka sqaruar studentëve që gazetaria hulumtuese nuk duhet të jetë gjithmonë negative, ajo mund të jetë edhe pozitive. Ndërsa, ai porositi studentët dhe të tjerët që ushtrojnë këtë profesion se duhet të jenë përgjegjës për punën e tyre, duke respektuar privatësinë dhe nuk duhet të shfaqin gjuhë të urrejtjes. Ai tha se gazetari duhet të hulumtojë, dhe jo të mbajë një rrëzë po anën tjetër.

Gruber, ka gjetur rastin të flasë edhe për qasjen në informacione zyrtare, duke sqaruar madje edhe dallimin në mes qasjes në dokumente zyrtare dhe qasjes në informata publike. Ai tha se gazetarët duhet të kenë qas-



je në informatat publike. Mark Gruber porositi studentët, të cilët janë duke studiuar në fushën e medieve e që në të ardhmen mendojnë të ushtrojnë profesionin e gazetarit, të mos prekin jetën private të personave të ndryshëm, e që nuk kanë të bëjnë me interesin e publikut, dhe që të mos e rrezikojnë jetën

e tyre, pasi në Ballkan ka shumë shembuj që gazetarët keqtrajtohen.

Diskutimi mbi gazetarinë hulumtuese, i cili u zhvillua në Fakultetin e Komunikimit Masiv në AAB u përcoll me një varg diskutimesh edhe nga ana e studentëve.

Studentët e AAB-së për vizitë studimore në Gjermani

Një grup prej 12 studentësh të nivelit master të Fakulteti të Shkencave Sociale të Universitetit AAB, të shoqëruar nga stafi mësimdhënës i AAB-së, sot udhëtuan për një vizitë pesëditore studimore në institucionet përkatëse në Gjermani.

Në Gjermani ata do të vizitojnë Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Nürnberg-ut dhe të Heidenheim-it. Në këto qytete ekipi do të vizitojë edhe qendrat për punë sociale e ato për përkujdesjen e fëmijëve e të rinjve.

Gjithashtu, në agjendën e vizitës studimore, është edhe qyteti universitar i Ha-

idelbergut.

“Vizita realizohet në kuadër të punës praktike dhe përgatitjeve të temave të masterit për këtë grup të studentëve. Gjatë vizitës do të zhvillohen takime edhe me rektoratet e universiteteve e të fakulteteve përkatëse. Disa studentë do të angazhohen edhe në hulumtime të përbashkëta sociale në të dyja vendet me kolegët e tyre gjermanë për hartimin dhe finalizimin e temave të masterit sipas programit të studimeve”, ka shpjeguar Xhavit Rexhaj, prorektor për Marrëdhënie Ndërkombëtare.



Blerina Kuçi ligjëroi para studentëve të Fakultetit Ekonomik



Me ftesë të dekanes së Fakultetit Ekonomik, prof. Vjollca Hasani, znj. Blerina Kuçi, zyrtare e njësive së burimeve njerëzore në ProCreditBank, mbajti një ligjëratë para studentëve të po këtij fakulteti, drejtimi Banka, Financa dhe Kontabilitet.

Tema që u elaborua para studentëve nga znj. Kuçi, ishte për rolin dhe funksionimin e institucionit bankar në Kosovë-ProCreditBank, dhe njëkohësisht për mundësitë dhe kriteret e kërkuara për t’u punësuar në këtë institucion.

U paraqit programi i praktikës, i cili ofrohet dy herë në vit, që synon të rekrutojë të rinj, të cilët do të kenë mundësi të përfshihen në njësi të ndryshme të bankës në baza individuale dhe programi për bankierë të rinj, i cili kryesisht targeton studentët në përfundim të studimeve nga fusha relevante, program ky që kërkon përkushtim dhe angazhim të lartë të punës ekipore. Individë, të cilët tregojnë performancë të lartë nga programi për bankierë të rinj, kanë mundësi të jenë të punësuar në institucionin në fjalë.

Duke qenë se kuadrot e reja janë potencial i dobishëm për bankën në fjalë, përveç akomodimit, studentëve u ofrohen bursa paralele në kuadër të punës praktike si një mbështetje modeste.

Mënyra e realizimit të këtyre programeve është mjaft unike, ligjërata, praktika, ese dhe studentët e pranishëm parashutuan një sërë pyetjesh që u interesonin atyre për mundësinë e përfshirjes, numrin e kandidatëve që mund të aplikojnë, procesin e përzgjedhjes, etj.

Prof. Agim Vinca: Vepra “Shtini n’dhe këto fjalë” lexohet lehtë, por nuk shlyhet nga kujtesa



Në praninë e disa krijuesve të letrave shqipe, miqve të librit, kritikëve letrarë, studiuesve të fushave tjera, publicistëve dhe një numri dashamirësish të fjalë artistike, me rastin e 21 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Poezisë, në ambientet e Universitetit AAB dhe në bashkëpunim me PEN Qendrën e Kosovës, u bë promovimi i librit “Shtini n’dhe këto fjalë”, i poetit Lulzim Tafa, botuar nga Shtëpia Botuese “Faik Konica”. Redaktor i librit është Nazmi Rrahmani, ndërsa recensent Agim Vinca.

“Thënë troç, lexohet lehtë, por nuk shlyhet nga kujtesa” tha në fjalë e tij recensenti prof. dr. Agim Vinca, i cili shtoi më pas, se njezet e sa vjet më parë, takova Lulzim Tafën i cili kishte sjellë për lexim dorëshkrimin e librit të tij të parë me poezi, të cilin kishte dëshirë ta botonte si libër me pas, e rekomandova për botim në cilësinë e recensentit, sepse në vargjet e tij, sado të thjeshta, pashë një poet që po vinte, një krijues që kishte një botë te vetën shpirtërore, të cilën dëshironte t’ua ofron lexuesve mënyrën e vet, dhe dorëshkrimin ia dërgova ish poetit Ali Podrimja, i cili ia dha vizën për botim.



Kështu, në këtë mënyrë më “Gjakun që nuk bëhet ujë”, filloi karriera artistike e Lulzim Tafës, dhe duke lënë mënjane modestinë, se si poet është zbulim i imi. Lulzim Tafa, sot pa dyshim emër i njohur jo vetëm në fushën e poezisë, por edhe në atë të publicistikës, të drejtësisë si shkencë, të drejtave të njeriut, si dhe të jetës sonë intelektuale e akademike në përgjithësi. Por përveç angazhime të mëdha që ka sot Lulzim Tafa ka mbetur në thelb poet; një poet i veçantë e origjinal si për nga ndjeshmëria thellësisë lirike, por aspak patetike, ashtu edhe për nga mënyra e artikullimit të shprehjes poetike.

Profesor Vinca, siç e ka thek-

suar edhe në parathënie me të cilën hapet ky libër, e ritheksoi se poezia me e re e Lulzim Tafës është refleks i kohës në të cilën jetojmë. Tema, idetë, figurat, fjalori poetik, gjithçka mban ngjyrën e kësaj kohe. “Shtini n’dhe këto fjalë”, “Vdekja çon fjalë” dhe i “I kam edhe dy fjalë”, në këta tre libra të Lulzim Tafës shpaloset që në titull raporti i subjektit lirik më fjalë. Ky raport është në harmoni me filozofinë jetësore dhe përvojën historike të njeriut të kësaj toke. Poezia e Lulzim Tafës tingëllon si një bisedë inteligjente me lexuesin: është poezi që të bën për vete si me emocion që transmeton, ashtu edhe me ekspresivitetin e saj gjuhësor. Thënë troç, lexohet lehtë, por nuk shlyhet

nga kujtesa.

I pranishëm në këtë promovim ka qenë edhe redaktor i librit Nazmi Rrahmani, i cili është shprehur teje i kënaqur krijimtarinë e poetit Lulzim Tafa, në përgjithësi e në veçanti me librin sapo të promovuar.

Ndërsa prof. dr. Sali Bashota, përfaqësues i PEN Qendrës së Kosovës, duke folur për librin “Shtini n’dhe këto fjalë”, të autorit, Lulzim Tafa, tha se libri poetik dëshmon se akti i frymëzimit i sistemuar në relacione ligjërimore midis ndjenjës së përfytyruara dhe mendimit kryengritës, duke funksionalizuar magjinë e fjalës të krijojë një efekt të veçanet estetik, i cili e provokon lexuesin, pikërisht dhe shterimin e kuptimeve përbrenda trupit të poezisë.

Duke i falënderuar të pranishmit si prindër, familjarë dhe miq, shkrimtarë dhe krijuesit e letrave, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të AAB-së dhe të ftuar të tjerë AAB-së dhe të ftuar të tjerë poeti, autori i librit, prof. dr. Lulzim Tafa tha: “Të jesh poet para se gjithash mendoj të jesh edhe me fat, kush tjetër përveç poetit dhe ku tjetër përveç në poezi t’i mund ta admirosh krijuesin e gjithësisë, dashurinë, jetën, atdheun dhe pastaj të kthehesh dhe t’iu kundërvihesh atyre. Lufton me tërë qenien tënde për të mirën ndaj të keqes

e kur e vlerëson se e ke fituar betejën kthehesh dhe e shkruan një poezi, lavdia i takon djallit. Gjetja si poet në këtë kohë mendoj që është fat”, përfundoi Tafa.

Promovimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ku performuan piano Elizabeta Musliu dhe soprano Elikona Hysa, ndërsa madhështinë ia kanë shtuar edhe dy aktorët me poezitë e recituara të zgjedhurat nga libri “Shtini n’ dhe këto fjalë”, si Anisa Ismaili dhe Ermal Rexha, dhe mysafirët e tjerë të shumtë.

Poeti Lulzim Tafa, është prezent në letërsinë shqipe për dy dekada e gjysmë, ndërsa numërohet si njëri ndër poetët më të njohur dhe më të përkthyer të letërsisë shqipe në botë. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë të botës, si: angleze, gjermane, italiane, serbokroate, boshnjake, rumune, frënge, arabe, greke, turke, suedeze, etj. dhe janë përfshirë në disa antologji, ndërsa është shpërblyer me shumë çmime letrare. Libri “Shtini n’ dhe këto fjalë” i Lulzim Tafës, është botuar nga Shtëpia Botuese “Faik Konica” nga Prishtina. Nga fusha e letërsisë, ky është libri i tij i gjashtë, ka 125 faqe dhe mbi 90 poezi, dhe përbëhet nga gjashtë cikle (Paketimi i mërzisë, Ikje, Te Hana, Gurë e dru, Tundimi dhe Kryengritja e muzave), që sajojnë një tërësi homogjene tematike dhe artistike.



AAB edhe në ShBA, përmes ekspozitës së dy profesorëve të arteve



Fitim Aliu dhe Hajrush Fazliu, mësimdhënës të Fakultetit të Arteve në AAB, do të prezantohen me një ekspozitë të përbashkët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ekspozita do të hapet më 17 prill dhe do të mbetet e hapur deri më 29 të po

këtij muaji në Galerinë Art Community Center në Fort Worth të SHBA, kanë njoftuar artistët Aliu e Fazliu.

Të dy mësimdhënësit, autorë të kësaj ekspozite të përbashkët do të jenë prezentë edhe në hapjen e ekspozitës në ShBA.



U publikua numri më i ri i revistës “COLLOQUIUM”

U publikua numri më i ri i revistës së studentëve të Fakultetit të Gazetarisë në AAB “COLLOQUIUM”.

Numrin e ri të kësaj revistës mund ta shfletoni në uebfaqen: <http://aab-edu.net/sq/aab-media/gazeta-colloquium>, dhe ta shkarkoni në attach...

“COLLOQUIUM” është revistë e studentëve të AAB-së, e cila del dy herë brenda një viti akademik.



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës të AAB, pjesë e workshopit “Linking Albania, Kosova and Macedonia”



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës të AAB, kanë qenë pjesë e projektit – workshop, lëvizës shtatëditor “LinkingAlbania, Kosova and Macedonia” të organizuar nga Universiteti Teknik i Vjenës. Studentë dhe mësim-

dhënës të Fakultetit të Arkitekturës që morën pjesë në këtë punëtori ishin: prof. Bujar Demjaha dhe prof. Dukagjin Hasimja, dhe studentët Yllka Qarri, Rinor Koca, Rina Kastrati, Feriz Kadriu dhe Blerina Hashani.

Punimet e kësaj punëtorie mobile u zhvilluan në Prishtinë, Tetovë, Tiranë dhe në Vjenë.

Dita e dytë e punëtorisë, u mbajt më 27 mars 2015 në ambientet e Universitetit AAB.



Kolegji AAB
CILËSI. LIDHSHIP. SUKSESI



IPAG
Business School
Paris, Tbilisi, Kyiv, London



KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

Fakulteti i Komunikimit Masiv, Kolegji AAB, Prishtinë
Departamenti i Gazetarisë dhe i Komunikimit, FHF, Universiteti i Tiranës
IPAG Business School, Paris
Ecole Supérieure de Journalisme (ESJ), Paris

Prishtinë, 29-30 maj, 2015

INFORMACIONI MASIV GLOBAL DHE KULTURAT KOMBËTARE

- 1 Aksi i parë:
Media masive dhe kultura kombëtare
- 2 Aksi i dytë:
**Sistemi i informimit masiv të qytetarit:
Qytetar i informuar apo i keqinformuar?**
- 3 Aksi i tretë:
**Kuadri normativ i mediave shqiptare:
Sa i shërbejnë mediat identitetit kulturor kolektiv shqiptar?**
- 4 Aksi i katërt:
Mediat mbarëshqiptare mes mediave lineare dhe mediave të reja

<http://konferencat.aab-edu.net/iccms>

Kontakti: Zija Rexhepi, tel: tel.: +381(0)38 555 444 loc.123, email: iccms@aab-edu.net

Eutanazia

Sikurse të gjithë shumë mirë e dimë, tashmë në shekullin tonë, asnjë individ nuk i mohohet e drejta për jetë siç nuk i mohohen shumë të drejta të tjera të parapara me Konventa dhe Deklarata Universale. Pyetja që vjen në shprehje është, pse duhet t'i mohohet e drejta për vdekjen e tij? Pse duhet t'i mohohet e drejta për të zgjedhur se me çfarë mënyre do që të vdesë apo në cilin vend apo në cilën kohë?

Kur bëhet fjalë për Eutanazinë, shumë njerëz mbështesin mendimin se askujt nuk duhet t'i ndalohej kjo e drejtë. Ata mendojnë që nëse personi i cili do një vdekje të lehtë për shkak të sëmundjeve të ndryshme të pashërueshme, të njëjtit duhet t'i jepet kjo e drejtë që të zgjedh për veten e tij. Por problemi shfaqet kur vjen fjala tek personat, të cilët nuk mund të komunikojnë dhe janë të paralizuar për një kohë të gjatë, pa ekzistuar mundësia për një përmirësim në të ardhmen. Këtu pikërisht shfaqet debati më i madh për të gjithë njerëzit dhe pyetja është, se si mund ta dijë dikush se çfarë do në të vërtetë personi i sëmurë? A është në të vërtetë zgjidhja më e mirë për atë, apo është zgjidhja më e mirë për njerëzit e tij të afërm, të cilët ndoshta nuk mund ta shohin dot ashtu dhe marrin vendimin e tillë duke u bazuar edhe në emocionet dhe gjendjen psikologjike të tyre?

Dhe pikërisht këtu do të doja të mbaroja prologun tim të shkurtër duke cituar një thënie të John Wooden i cili është shpreh : “Konsideroni të drejtat e të tjerëve para se të konsideroni ndjenjat tuaja... dhe ndjenjat e të tjerëve para se të drejtat tuaja.” (John Wooden, Quotable Wooden, Taylor Trade Publishing, 2012).

Çfarë është Eutanazia

Fjala eutanazi e ka origjinën prej gjuhës Greke dhe përbëhet prej dy fjalëve të cilat janë “eu” (”) e cila përkthet si e “mirë” dhe prej fjalës “Thanatos” (”) e cila do të thotë vdekje. Bashkimi i këtyre dy fjalëve pra, përbën fjalën eutanazi e cila kuptohet si një vdekje e mirë, një vdekje e lehtë. Po ashtu ek-

ziston edhe definicioni që i ka dhënë Etika Medicinale fjalës eutanazi, i cili është: “ndërrhyrja e menduar mirë, e ndërmarrë me qëllimin e qartë për t'i dhënë fund jetës, për të lehtësuar në këtë mënyrë dhimbjet apo vuajtjet e rënda të një personit”.

Historik i shkurtër

Besohet se eutanazia ka ekzistuar prej kohëve të lashta në Greqinë dhe në Romën e lashtë. Në atë kohë në Greqi aplikoheshin më shumë abortet e grave shtatëzane dhe pak më rrallë aplikohesh vdekja e mëshirshme siç e quanin Greket e lashtë. Gjatë kohës së Mesjetës eutanazia ishte absolutisht e ndaluar dhe po ashtu ishte edhe vetëvrasja. Nëse dikush vendoste që të vetëvritej, ligji në Evropë, në atë kohë ka qenë shumë i ashpër. Ligji thoshte se trupi i pajetë do të merrej dhe do të zhvarritej nëpër rrugët e qytetit ose do të gozhdohej në një fuçi dhe do të lëshohej që të binte në lumë.

Gjatë shekujve 17 dhe 18 eutanazia ishte një tem e cila diskutohej shumë por megjithatë shumica e njerëzve nuk e pranonin dhe ishin kundër saj. Në vitin 1828 për herë të parë në Amerikë u vendos ligji i cili e bënte eutanazisë të kundërligjshme edhe pse disa shtete të Amerikës vazhdonin debatin për ta legalizuar atë. Me kalimin e kohës gjatë viteve 1930-1939 eutanazia filloi të mbështetetej nga shumica e njerëzve, jo vetëm në Shtet e Bashkuara por edhe në Mbretërinë e Bashkuar. Por, megjithatë, Lufta e Dytë Botërore e ndryshoi eutanazinë dhe e bëri atë që të marrë një figurë negative, për shkak të krimeve kundër njerëzimit të cilat u kryen prej pushtetit nazist të Hitlerit.

Hollanda ishte shteti i parë i cili e bëri eutanazinë të ligjshme dhe më pas disa shtete të tjera do të ndiqnin të njëjtat hapa.

Për sa i përket vendeve tona në Shqipëri eutanazia është e kundërligjshme dhe nuk ekzistojnë të dhëna apo informata për ndonjë rast kur është aplikuar. Dhe po ashtu e njëjta gjë vlen edhe për Kosovën, ku nuk është

shfaqur interesimi i madh nga ana e ekspertëve apo opinionit të përgjithshëm.

Shtetet që e aplikojnë

Zvicra: Zvicra e lejon sigurimin e substancave medicinale të cilat mund të shkaktojnë vdekje tek një person, duke marr parasysh që personi duhet të ketë një rol aktiv në këtë procedurë. Megjithatë, kodi penal i Zvicrës i vitit 1942 e konsideron vetëvrasjen e asistuar si një krim nëse ekzistojnë motive vetiake.

Holanda: Në vitin 2002 ishte shteti i parë i cili legalizoi eutanazinë dhe po ashtu vetëvrasje e asistuar.

Belgjika: Në vitin 2002 ishte shteti i dytë pas Holandës i cili legalizoi eutanazinë.

Luksemburgu: Parlamenti i shtetit ka aprovuar ligjin për eutanazinë në 2008.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Edhe pse në Shtetet e Bashkuara eutanazia aktive është e kundërligjshme, vetëvrasja e asistuar është e ligjshme në këto shtete të SHBA-së : Oregon, Vermont, Washtington dhe Montana.

Pikëpamjet Morale

Kur tema arrin tek çështja morale e eutanazisë, krijohen shumë pyetje të ndryshme dhe po ashtu krijohen shumë dilema. Pikëpamjet e secilit individ mund të jenë të natyrës së ndryshme megjithatë nëse marrim parasysh disa këndvështrime më të njohura eutanazia nuk pranohet si një mënyrë për të vdekur. Ky fakt bazohet në betimin e Hipokratit të cilit të gjithë mjekët duhet t'i nënshtrohen dhe në të njetën kohë ta respektojnë si ligj. Betimi i Hipokratit konkretisht thotë :

“Betohem për mjekun Apollo e Asclepio e Igea e Panacea dhe për të gjithë zotat e tjerë, duke i thirrur si dëshmitarë, se do të zbatoj më të gjithë forcën dhe gjykimin tim, këtë betim dhe këtë angazhim:

“Nuk do t'i jap askujt, edhe neqoftë se e kërkon, një mjekim vdekjeprurës, dhe as nuk do të sugjeroj një këshillë të tillë”.

Megjithatë, shumë njerëz besojnë se veprime të tilla dobësojnë respektin e shoqërisë për rëndësinë e jetës.



Pra, mund të thuhet se duke pranuar eutanazinë pranohet edhe një fakt që mund të interpretohet sikur disa jetë (jetët e njerëzve të sëmurë apo invalid) konsiderohen si më pak të rëndësishme se disa tjera dhe kjo është diçka e papranueshme nga të gjitha shoqëritë e kohës tonë. Gjithmonë duke folur për aspektin moral të eutanazisë, disa besojnë që eutanazia është veç se një fillim të një “përrësie të rrëshqitshme” e cila mund të na shpien në eutanazi të pa-vullnetshme dhe në vrasje të njerëzve të cilet konsiderohen si të padëshirueshëm dhe si rezultat mund të dalë që eutanazia në disa raste ndoshta nuk është në interesin më të mirë të pacientit.

Procedura e Eutanazisë

Në shtetet të cilat e aplikojnë eutanazinë, duhet të parashtrohet kërkesë nga personi i cili është pacienti ose nga personi i autorizuar të cilin i njëjti e ka autorizuar për të ndërmarrë veprime procedurale lidhur me këtë çështje. Kur kërkesa parashtrohet, duhet gjithmonë të përmbajë arsyet dhe faktet të cilat vërtetojnë gjendjen faktike apo situatën e vështirë të cilën është duke kaluar pacienti. Ekzistojnë raste të tjera kur personat të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda dhe nuk kanë mundësi shërimi apo përmirësimi, kanë të drejtën të kërkojnë prej mjekëve që t'i ndalohej terapia e mjekimeve apo ilaçeve të ndryshme të cilat e mbajnë personin gjallë. Varësisht prej shtetit dhe prej legjislacionit aktual të secilit shtet, procedura mund të ndryshoj pak ose shumë në raste të ndryshme. Megjithatë për të ndërmarrë një veprim të

tillë duhet më parë të bëhet e lejueshme prej organeve të drejtësisë dhe më konkretisht prej gjykatës, e cila e shqyrton lëndën dhe sipas fakteve dhe gjendjen e situatës të personit vendos të aprovoj apo të mos aprovoj një kërkesë të tillë për eutanazi.

Mënyrat e Eutanazisë

Kur bëhet fjalë për mënyrat apo format e eutanazisë, eutanazia mund të kryhet në disa mënyra. Pra ekzistojnë këto lloj të eutanazisë:

Eutanazia aktive: është forma e eutanazisë kur një person drejtpërdrejtë dhe me paramendim shkakton vdekjen e personit të sëmurë.

Eutanazia pasive: kjo formë e eutanazisë nënkupton rastet kur një person shkakton vdekjen e personit tjetër i cili është i sëmurë, në një mënyrë indirekte. Kjo mund të bëhet duke ndaluar trajtimin e ilaçeve antibiotik apo mjekimeve të ndryshme ose në disa raste duke fikur aparataturat të cilat janë duke e mbajtur gjallë personin konkret. Pra mund të themi se vdekja në këtë rast shkaktohet me anë të mosveprim-it.

Eutanazia mundet po ashtu të klasifikohet edhe në:

Eutanazi vullnetare: e cila nënkupton situatën kur personi zgjedh vetë dhe vendos të bëjë kërkesën për vdekjen e tij me anë të eutanazisë.

Eutanazi jo-vullnetare: Kjo nënkupton situatat kur personi i cili është në komë apo i paafte mentalisht që të marrë një vendim të tillë dhe një person tjetër detyrohet që ta marrë vendimin për të njëjtin.

Eas Hida, student në Fakultetin Juridik në AAB

Prishtina bën histori

Skuadra e Sigal Prishtinës ka arritur të fitojë trofeun e parë ndërkombëtar për sportin e Kosovës, pasi që e ka mposhtur në finale të Ligës Ballkanike skuadrën bullgare të Rilskit me rezultat, 71-80.

Bullgarët e nisën mirë ndeshjen dhe u rritën në lojën e tyre duke krijuar edhe një epërsi prej 10 pikëve (16-6) pas vetëm katër minutash lojë. Mirëpo, Bardhekalterit filluan ta shkrijnë këtë epërsi përmes sulmeve të mençura të finalizuara nga Edin Bavic, duke arritur që ta mbyllin çerekun e parë me katër pikë disavantazh, 26-22.

Në çerekun e dytë, Bardhekalterit ia dolën që mjaft mirë t'i mbulojnë dy lojtarët më të rrezikshëm të Rilskit, Rakocovic dhe Taylor, me ç'rast arritën edhe të dalin në

epërsi. Ishte Julian Mavunga ai që ishte më i disponuari në këtë fazë të lojës, teksa arriti të shënojë dy trepikësha tejet krucial. Prishtina e përfundoi pjesën e parë me dy pikë epërsi, 36-38.

Bardhekalterit e nisën mirë çerekun e tretë dhe në përgjithësi e kontrolluan tempon në këtë pjesë lojë, teksa Jordan Hulls dhe Dardan Berisha shënuan pikë të rëndësishme për ta përmbyllur këtë periudë me pesë pikë epërsi, 52-57.

Hulls e nisi çerekun e katërt me një trepikësh, duke i dhënë zemër Bardhekalterve

për një përfundim ëndërrash. Trajneri Marian Ilievski i dha instruksione skuadrës që të sulmojnë, dhe Bardhekalterit iu vërsulen kundërshtarit si një tufë luanësh duke i shkelur ata në çdo aspekt. Prishtinasit në minutat e fundit ishin thjeshtë të pakapshëm, duke realizuar aksione të tipit alla NBA, teksa arritën ta përfundojnë ndeshjen me rezultat bindës, 71-80.

Ky është titulli i parë i sporteve grupore për Kosovën, dhe Prishtina arriti ta fitojë atë në mënyrën më të denjë.



Çfarë synon Kosova të arrijë në Olimpiadë

Reprezentacioni i Kosovës do të marrë pjesë në Festivalin Olimpik të Evropës për të rinj (EYOF).

Ky eveniment, i 13-ti me radhë, këtë vit do të mbahet në Tbilisi të Gjeorgjisë, duke filluar nga 26 korriku e deri më 1 gusht. Siç njofton Besim Hasani, kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Kosova në këtë Festival Olimpik do të marrë pjesë me së paku 26 sportistë nga gjashtë sportet në vijim: Atletika, Noti, Çiklizmi, Xhudo, Gjimnastika dhe Tenisi. Kjo do të jetë një mundësi ideale për



shpresat olimpike kosovare, që ta tregojnë veten në një eveniment të rëndësishëm si

ai i Tbilisit, ku do të marrin pjesë moshatarët e tyre nga mbarë Evropa.

Përgatiti: Albert Canolli

Studentët e AAB-së pjesëmarrës në “Universiadën ndërkombëtare të skijimit – Korçë 2015”

Dy studentë të Fakultetit Kulturë Fizike dhe Sport, Petrit Prekazi dhe Egzon Rexhepaj bashkërisht me stafin akademik Zenel Metaj dhe Rizvan Rexhaj, gjatë këtyre ditëve kanë marrë pjesën “Universiadën ndërkombëtare të skijimit – Korçë 2015”, në Shqipëri.

Përveç Universitetit AAB, në këtë aktivitet kanë marrë pjesë edhe institucione tjera universitare si: Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore, Universiteti i Sporteve – Tiranë dhe Universiteti i Korçës.




Studentët e AAB-së, të suksesshëm në Gjysmëmaratonën e Prishtinës

Studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit AAB u treguan mjaft të suksesshëm në Gjysmëmaratonën “Prishtina 2015”, e cila u mbajt fundjavën që shkoi. Në këtë eveniment prestigjioz dhe masiv, ku morën pjesë atletë elitare botëror, pjesëmarrës ishin gjithsej 1200 atletë, ndërsa në mesin e tyre kishte edhe studentë të AAB-së.

Më të suksesshmit nga radhët e studentëve të AAB-së, në këtë garë dolën Arian Gashi (1:24) i cili e zuri vendin e 10-të dhe Gazmend Gashi (1:28), i cili përfundoi i 21-ti.

Vlen të ceket se studentët e këtij fakulteti, thuajse në çdo organizim janë pjesëmarrës dhe çdo herë tregohen të suksesshëm.





The British School of Kosova

Shkollë 12 vjeçare, e licensuar nga MASHT



ATY KU
NXENESIT
DUAN TE
MESOJTNE

12000 €
për vit shkollor



Niveli parafillor
(grup-mosha 5 - 6 vjeç)

Niveli fillor
Klasa e parë

Niveli i mesëm i ulët
Klasa e gjashtë

Regjistrohu tani

038 556 566

045 575 777

britishschoolkosova.com

Magjistranja Prishtinë - Fushë Kosovë (afër Kolegjit AAB)





**Bleje banesën me këste
për 3 vite pa kamatë**



cilësi, lidership, sukses!



**Institucioni i Arsimit
UNIVERSITAR AAB**

EKONOMIK

- BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET
- MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI
- MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

SHKENCA KOMPJUTERIKE

- INXHINIERI SOFTUERIKE
- KOMUNIKIMI NË RRJETA
- TELEKOMUNIKIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT (IT)
- MEKATRONIKË

MENAXHIM SEKTORIAL

- MENAXHIMI I ARSIMIT
- MENAXHIMI I KULTURËS
- MENAXHIMI I SPORTEVE
- MENAXHIMI I SHËNDETËSISË

JURIDIK

KRIMINALISTIKË

INTEGRIME EVROPIANE

KUJDESI DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

AAB ju ofron mundësinë që të studioni në gjuhën angleze në Programet Ndërkombëtare të Universitetit të Londrës

London School of Economics and Political Science:
me programet **Bachelor** dhe
Royal Holloway me programet **Master**

GJUHË ANGLEZE

KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI

- GAZETARI
- PRODUKSION

ADMINISTRATË PUBLIKE

SHKENCA POLITIKE DHE DIPLOMACI

KULTURË FIZIKE DHE SPORT

ARKITEKTURË

DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA

DIZAJN ENTERIERI

DIZAJN I MODËS

PIKTURË DHE ARTE VIZUELE

MUZIKË

INFERMIERI (në proces të akreditimit)

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Tel: 038/ 555 444; 038/ 601 019

Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666

Dega në Gjakovë: 0390/ 327 444, 045/ 552 333

Dega në Ferizaj: 0290/ 328 908, 044/ 77 90 90

info@aab-edu.net

www.aab-edu.net

[f /UniversitetiAAB](https://www.facebook.com/UniversitetiAAB)